

unicef 
for every child

ANALIZA E GJENDJES SË
**GRAVE DHE
FËMIJËVE**
NË MAQEDONISË SË VERIUT



REZYME E PËRGJITHSHME

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

342.7-053.2(497.7)

BËRN, Kevin

Analiza e gjendjes së grave dhe fëmijëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut [Електронски извор]
: rezime e përgjithshme / Kevin Bërn. - Shkup : UNICEF, 2020

Начин на пристап (URL): <https://www.unicef.mk>. - Текст во PDF формат, содржи 25 стр., илустр. -
Наслов преземен од екранот. - Опис на изворот на ден 28.02.2020

ISBN 978-608-4787-68-6

а) Права на детето - Заштита - Македонија COBISS.MK-ID 112310538

Ky raport është zhvilluar me kërkesë të Fondit të Kombeve të Bashkuara për Fëmijë (UNICEF) dhe është përgatitur nga konsulenti Kevin Bërn. Qëndrimet e këtij raporti janë këndvështrime të autorit dhe nuk është patjetër ato të përputhen me qëndrimet dhe politikat e UNICEF-it.

ANALIZA E GJENDJES SË
**GRAVE DHE
FËMIJËVE**
NË MAQEDONISË SË VERIUT



REZYME E PËRGJITHSHME





a. Konteksti

UNICEF-i e ka porositur këtë analizë të pavarur për t'i identifikuar dhe adresuar pengesat, dhe mundësitë për përmbushjen e plotë të të drejtave të të gjithë fëmijëve, që jetojnë në Maqedoninë e Veriut. Analiza në fjalë synon ta zgjerojë dhe azhurnojë bazën ekzistuese të njohurive, veçanërisht në lidhje me barazinë dhe gjininë, duke shpresuar se të gjitha palët përkatëse do ta shtojë kuptimin e statusit aktual të të drejtave të fëmijëve në Maqedoninë e Veriut. Qëllimi kryesor i saj është t'i nxjerrë në pah përparësitë strategjike të nevojshme për t'i zvogëluar pabarazitë dhe për t'i adresuar pikat vulnerable (të cenueshme), të ndihmojë në formimin e agjendës së zhvillimit nacional dhe me paanësi ta përshpejtojë përmbushjen e Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm (QZHQ)¹.

Ky studim e përvetëson një qasje të bazuar në të drejta, e cila e vendos fëmijën në qendër të procesit të hulumtimit dhe e filtron analizën e të dhënave të disponueshme nën prizmin e nenit 2.1 të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve. Pra studimi e shqyrton situatën e të gjithë fëmijëve në Maqedoninë e Veriut, mirëpo përqendrohet në kategorinë veçanërisht vulnerable dhe në



rrezik p.sh. fëmijët romë, fëmijët me aftësi të kufizuara; fëmijët në kujdesin institucional; fëmijët në paraburgim. Kudo që të jetë e mundur, analiza zbërthehet në bazë të gjinisë, përkatësisë etnike dhe rajonit. Vëmendje e veçantë i kushtohet sjelljes, qëndrimeve dhe vlerave të familjeve, traditave dhe kulturës së komunitetit, të cilat ndikojnë në realizimin e të drejtave të fëmijëve.

Thelbi i analizës është ekzaminimi i bllokimeve, të cilat e parandalojnë ose pengojnë fëmijën nga mundësia e gëzimit të të drejtave të tyre. Ajo mbështetet në analizën e studimeve ekzistuese, gjegjësisht raporteve, anketimeve dhe të dhënave statistikore ekzistuese; intervistat gjysmë të strukturuar me informatorët kryesorë të marra nga Qeveria dhe shoqëria civile; konsultimet me stafin kyç të UNICEF-it; dhe diskutimet në fokus grupe (DFG) me një mostër prej 65 fëmijëve dhe adoleshentëve të moshës 15-18 vjeçare nga një spektër i lokacioneve, dhe grupesh etnike dhe socio-ekonomike të ndryshme.

Kjo Analizë e situatës është përpiluar gjithnjë sipas Procedurave për standarde etike të UNICEF-it për hulumtim, evaluim, grumbullim të të dhënave dhe analizë të tyre, si dhe në bazë të standardeve hulumtuese për përfshirjen e fëmijëve.

¹ Transformimi i botës sonë: Agjenda 2030 e Rezolutës 70/1 për Zhvillim të Qëndrueshëm e miratuar në mbledhjen e 70-të të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara me 25 shtator 2015 gjendet në <https://sustainabledevelopment.un.org/post2015/transformingourworld>

72 për qind e popullsisë jetojnë në mjediset urbane, ndërsa përqendrimi më i madh haset në Shkup me (20.5%).



b. Lokacioni gjeografik dhe profili demografik

Maqedonia e Veriut është një vend i vogël në Evropën Juglindore, i cili kufizohet me Serbinë dhe Kosovën² në veri, Bullgarinë në lindje, Shqipërinë në perëndim dhe Greqinë në jug. Shteti gjendet në rrugën e migracionit mesdhetar lindor, gjegjësisht në rrugën e transitit midis Greqisë dhe vendeve anëtare të BE-së. Vendi mbulon një sipërfaqe prej 25.713 kilometra katrorë (km) me kufijtë e përgjithshëm prej 899 km. Rreth 80 për qind janë terrene kodrinore, malore dhe rreth dy për qind mbulohen nga uji. Lartësia mesatare e vendit është 830 metra, ndërsa klima është kontinentale e butë me njëlloj ndikimi mesdhetar³.

Vlerësimet zyrtare⁴ të bazuar në regjistrimin e fundit në 2002 tregojnë se popullsia e përgjithshme e Maqedonisë së Veriut në qershor të vitit 2017 ka qenë pak më shumë se dy milion banorë, e ndarë pothuajse në mënyrë të barabartë midis meshkujve (50.1%) dhe femrave (49.9%). Në

përgjithësi, popullsia e Maqedonisë së Veriut është duke u plakur, dhe ky është padyshim një faktor i rëndësishëm në përcaktimin e prioriteteve të politikave shëndetësore dhe sociale.

Përqindja e fëmijëve në popullsi ka rënë nga 24 për qind në vitin 2011⁵ në 22.5 për qind në vitin 2017, ndërsa përqindja e popullsisë së përgjithshme të moshës 65 vjeçare ose më shumë është rritur nga 12 për qind në 2011⁶ në 13.5 për qind në vitin 2017. Shkalla e pjellorisë ka rënë nga 1.48 në 2013 në 1.43 në 2017, që nuk është vetëm nën mesataren e BE-së (1.6), por gjithashtu shumë më poshtë se niveli i zëvendësimit (të një gjenerate nga gjenerata tjetër) (2.1)⁷. Shkalla e lindjeve në nivel nacional ka rënë nga 11 lindje të gjalla për 1000 kokë banorë⁸ në vitin 2011 në 10.5 për 1000 banorë në vitin 2017.

Rënia e nivelit të lindjeve mund të jetë pasojë e një rënie në shkallën e martesës nga 7.2 në 2011 në 6.6 në vitin 2017, ose si rezultat i martesave të vonuara. Shumica e lindjeve të gjalla (34.7%) kanë qenë

2 Ky përcaktim nuk i cenon pozicionet mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244/1999 të KS të OKB dhe Opinionin e GJND-së për shpalljen e pavarësisë së Kosovës

3 Të dhëna të marra nga Regjistri vjetor i statistikës së Republikës së Maqedonisë, 2018 Kapitulli 03 Popullsia, Enti Shtetëror i Statistikës (2018) Shkup, Kapitulli 02. Mjedisë Jetësor dhe Gjeografia

4 Përpos nëse është theksuar më ndryshe, të dhënat e cituara në këtë pjesë janë marrë nga Regjistri vjetor i statistikës së Republikës së Maqedonisë, 2018 Kapitulli 03 Popullsia, Enti Shtetëror i Statistikës (2018) Shkup

5 Maqedonia në numra 2012, Enti Shtetëror i Statistikës, Shkup, 2012

6 Enti Shtetëror i Statistikës, Shkup 2013 www.stat.gov.mk

7 Milevska Kostova N, Chichevalieva S, Ponce NA, van Ginneken E, Winkelmann J. The former Yugoslav Republic of Macedonia: Health system review European Observatory on Health Systems and Policies/WHO (2017) Copenhagen gjendet në <http://www.healthobservatory.eu>

8 IMCH Annual Report, Skopje, 2011

fëmijë të nënave të moshës 25-29 vjeçare, ndërsa moshë mesatare e nënave për të gjitha lindjet e gjalla ka qenë 28.9 vjeç⁹. Ekziston një model i vonimit të martesës në një moshë më të vjetër - moshë mesatare në martesën e parë në vitin 2017 ka qenë 26.6 vjeç për nusen dhe 29.3 për dhëndrin¹⁰. Sido që të jenë arsyt, rritja e popullsisë po ngadalësohet, me një rënie të nivelit të rritjes natyrore nga 1.6 në 2011 në vetëm 0,7 në vitin 2017 dhe një rënie në indeksin e vitalitetit (numri i lindjeve në raport me 100 vdekje) nga 120.5 në 2013 në 107.1 në 2017.

Regjistrimi i fundit i popullsisë në vitin 2002 tregoi një ndarje në rritje e sipër mes vendbanimeve urbane/rurale, me 58 për qind të popullsisë që jeton në qytete, përqendrimi më i lartë (20.5 për qind) ishte në Shkup. Popullsia rurale është dukshëm më e privuar sesa popullsia urbane për sa i përket qasjes në shërbime. Të dhënat e Eurofound¹¹ tregojnë se 72 për qind e popullsisë ka jetuar në vendbanime urbane në vitin 2016, ndërsa vlerësimet¹² e Entit Shtetëror të Statistikës për vitin 2017 tregojnë se 45 nga 81 komuna kanë një rritje negative të popullsisë, padyshim e shkaktuar nga rënia e niveleve të lindjeve dhe migracioni. Migrimi është një tipar tradicional i shoqërisë së Maqedonisë së Veriut që ka shënuar rritje të qëndrueshme që nga viti 2000. Shkalla¹³ neto e migrimit tani qëndron në - 0,5 / 000 që do të thotë se më shumë njerëz po emigrojnë nga vendi sesa migrojnë në të. Në një studim¹⁴ të bërë kohëve të fundit në nivel shtetëror gjysma e të rinjve shprehën synimin për të emigruar në 1-2 vitet e ardhshme. Ky synim ishte më i fortë midis të rinjve të papunë; ata që identifikohen si shqiptarë ose pakicë tjetër etnike; dhe të rinjtë LGBTI. Gjinia nuk duket të jetë një faktor për sa i përket planeve për të emigruar.

Duke u bazuar në regjistrimin e vitit 2002, 64 për qind e popullsisë e përkufizojnë veten si maqedonas etnikë, ndërsa 25 për qind si shqiptar etnik. Shqiptarët etnikë e përbëjnë shumicën në rajonin veriperëndimor (Pollog), ndërsa janë pakicë e konsiderueshme në rajonet e Shkupit, Verilindjes dhe Jugperëndimit. Ndonëse zyrtarisht romët përbëjnë vetëm 2.66 për

qind të popullsisë, Këshilli i Evropës vlerëson¹⁵ se popullsia rome e Maqedonisë së Veriut është midis 134,000 (6.5%) dhe 260,000 (12.5%). Rreth 43 për qind e romëve jetojnë në Shkup, gjysma e tyre në komunën me shumicë rome të Shuto Orizarit.

c. Qeverisja dhe ekonomia politike

Maqedonia e Veriut është një demokraci parlamentare relativisht e qëndrueshme. Në përgjithësi partitë politike perceptohen si të bazuara në përkatësitë etnike, ndërsa Parlamenti e pasqyron përbërjen etnike të vendit. Që nga viti 2006, modeli i qeverisjes ka qenë koalicion i partive, të cilat i përfaqësojnë të dy grupet kryesore etnike. Zgjedhjet e fundit janë zhvilluar në vitin 2016, ndërsa zgjedhjet presidenciale janë zhvilluar në vitin 2019. Komisioni Evropian (KE) ka vënë në dukje në Raportin Vjetor të Progresit të Vendit (RPV)¹⁶ se kultura e kompromisit midis protagonistëve politikë është përmirësuar në saje të përpjekjeve të qeverisë aktuale për të arritur qasje të gjithë palët përkatëse, duke përfshirë opozitën dhe shoqërinë civile.

Ndonëse Maqedonia e Veriut ka miratuar legjisllacion, politika dhe strategji për të drejtat e fëmijëve në përputhje me normat dhe standardet ndërkombëtare, prapëseprapë është i ngadaltë përparimi drejt arritjes së këtyre standardeve. Ende mund të jetë e nevojshme reforma legjislative, mirëpo njëra nga rekomandimet¹⁷ kryesore të Komitetit për të Drejtat e Fëmijëve (KDF-së) ishte që t'i jepet përparësi implementimit e jo reformave. Vendit i mungon një strategji e pajtuar kombëtare për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, ndërsa organi ligjor i ngarkuar me mbikëqyrjen e realizimit të Konventës duket se është jofunksional.

Për nga struktura administrative vendi është i ndarë në 81 komuna, 10 prej të cilave i janë bashkëngjitur kryeqytetit, Shkupit. Decentralizimi paraqet një plan qendror i modelit të zhvillimit të vendit, ndërsa program i decentralizimit fiskal për komunat është

9 Gratë dhe burrat në Maqedoninë e Veriut, Enti Shtetëror i Statistikës (2018) Shkup

10 Ibid

11 Leonicas T. et al/Eurofound Life and society in the EU candidate countries, European Quality of Life 2016 series Publications Office of the European Union (2019) Luxembourg hereafter Eurofound 2019

12 Regjistri vjetor i statistikës së Republikës së Maqedonisë, 2018 Kapitulli 03 Popullsia, Enti Shtetëror i Statistikës (2018) Shkup

13 Shih Shkalla e migracionit e Maqedonisë, Index Mundi at https://www.indexmundi.com/macedonia/net_migration_rate.html


14 Zlvez L./ Navanti Group Vlerësim ndërsektorial i të rinjve, Maqedonia e Veriut USAID (2019) Shkup

15 Shihni Vlerësimet dhe numrat zyrtarë të romëve në Evropë, të azhurnuara në korrik të vitit 2012.xls.(01) Këshilli i Evropës <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTM>

16 Maqedonia e Veriut 2019 Raporti i Komisionit Evropian (maj 2019) Bruksel në tekstin në vijim RPSH 2019

17 CRC Concluding Observations: former Yugoslav Republic of Macedonia UNHCHR (2010) Gjenevë

Anekënd
vendit ndotja
e ajrit është në
gjendje të lart të
rrezikshmërisë
në mjediset e
banuara dhe ato
industriale.



ende në vazhdim e sipër. Shumica e komunave kanë mesatarisht¹⁸ rreth 22,000 banorë, mirëpo 34 sosh kanë popullsi më pak se 10,000, ndërsa 16 prej tyre kanë më pak se 5,000 banorë. Problemet e efikasitetit janë më të dukshme në këto komuna me popullsi të ulët, por shumica e komunave në Maqedoninë e Veriut përpiqen të sigurojnë një rrjet gjithëpërfshirës të shërbimeve për fëmijë, madje përkundër përparimit të konsiderueshëm, vendi ende ka vështirësi në arritjen e krijimit të një sistem të përgjegjshëm dhe efektiv të ofrimit të shërbimeve sociale, të cilat në mënyrë të duhur i përmbushin nevojat e fëmijëve vulnerabil dhe familjeve të tyre.

Modele sektoriale të ndryshëm të decentralizimit zbatohen për sa i përket shërbimeve të fëmijëve dhe ato duhet të hulumtohen më tej në lidhje me efektivitetin dhe efikasitetin e tyre. Pengesat në qasje bëhen më të dukshme në lidhjen ndërmjet kornizave ligjore, politike dhe strategjite e përcaktuara në nivel nacional dhe mekanizmat e ofrimit të shërbimeve vendore dhe sistemet e menaxhimit. Në disa zona të shërbimit, vendimet operative dhe shpërndarja e mjeteve duket se mbeten në nivel qendror, edhe pse përgjegjësia për caktimin e burimeve është transferuar në nivel lokal. Burimet kryesore të informimit e kanë identifikuar kapacitetin e dobët të stafit, vullnetin e dobët dhe ndryshimin e madh të stafit si faktorë kryesorë për cilësinë e dobët të shërbimeve dhe qasjen

e kufizuar. Madje ka prirje që këtë t'ia atribuojnë ndikimit negativ të kulturës së pranuar të patronazhit politik dhe politizimit të padrejtë të strukturave të qeverisjes vendore. Sidoqoftë rishikimet¹⁹ e pavarura tregojnë se i gjithë sistemi i transferimeve financiare ndërmjet qeverisë qendrore dhe lokale duhet të riformulohet me çka do të merren parasysh kapacitetet dhe kërkesat e komunave në mënyrë që të forcohet dhe mbështetet planifikimi dhe zhvillimi i shërbimit lokal afatgjatë.

Studimi i Eurofound për Hulumtimin evropian mbi cilësinë e jetës HECJ (EQLS) 2016²⁰ zbuloi se qytetarët e Maqedonisë së Veriut e vlerësuan cilësinë e shërbimeve të tyre publike më të ulët se çdo vend tjetër kandidat ose shtet anëtar i BE-së, dhe se vlerësimet e cilësisë kishin rënë ndjeshëm për të gjitha shërbimet që nga viti 2011. Korrupsioni dhe patronazhi politik mbeten çështje shqetësuese. Maqedonia e Veriut shënoi 37 pikë nga 100 në Indeksin²¹ e Perceptimit të Korrupsionit në vitin 2018. HECJ 2016²² gjithashtu zbuloi se nivelet e perceptuara të korrupsionit në të gjitha shërbimet janë gjithashtu më të larta se mesatarja e BE28.

Progresi në drejtim të reformës ekonomike dhe zhvillimit ka qenë i konsiderueshëm që nga pavarësia²³ e shtetit në vitin 1991. Tani Maqedonia e Veriut ka arritur statusin e vendit me të ardhura të mesme. Indeksi i Zhvillimit Njerëzor²⁴ IZHNI (HDI)

18 Të dhëna nga World Bank North Macedonia Public Finance Review: Sowing the Seeds of a Sustainable Future. World Bank. (2018) Washington, D.C.

19 Ibid.

20 Leonicikas T. et al Eurofound (2019) op cit.

21 Indeksi i korrupsionit në Maqedonia gjendet në <https://tradingeconomics.com/macedonia/corruption-index>

22 Eurofound (2019) op cit.

23 Eurofound (2019) op cit.

24 Human Development Index. Country Reports The former Yugoslav Republic of Macedonia UNDP (2018) gjendet në <http://hdr.undp.org/en/countries/profiles/MKD>

në 2018 vuri në dukje Bruto të Ardhurat Nacionale BAN (GNI) për kokë banori prej 12,505, ndërsa Raport i Progresit të Shtetit i Këshillit të Evropës (RPSH i KE-së)²⁵ shënoi një bruto prodhim vendor (BPV) për kokë banori ekuivalent me 37 për qind të BE28 në 2018. Programi i Reformës Ekonomike të Qeverisë PRE (ERP) është bazuar në një përshtetje të moderuar të rritjes nga 3.2 për qind në 2018 në 4.0 për qind në vitin 2020, kryesisht i nxitur nga eksportet, konsumi privat dhe investimet. Megjithatë, rritja shkon nga një bazë fillestare shumë e ulët, ndërsa vendi mbetet një nga më të varfrit në Evropë.

d. Profili i rrezikut humanitar

Analizë e relievit klimatik ARK²⁶ (CLA) kohëve të fundit ka vënë në pah reshjet dhe temperaturat që ndryshojnë shumë në veri të Maqedonisë, ku mjediset me nivel më të lartë mbidetar kanë përafërsisht dyfishin e reshjeve mesatare vjetore të vendeve më të ulëta, po ashtu hasen ndryshimet stinore deri në 70°C dallim midis temperaturave të verës dhe dimrit. Vitet e fundit numri i reshjeve në nivel vjetor ka shënuar ulje të vazhdueshme, ndërsa janë rritur temperaturat mesatare. Nëse këto tendenca vazhdojnë, një rritje të përgjithshme e thatësisë kërcënon pothuajse të gjithë relievin.

Observatori Sizmologjik në Fakultetin e Shkencave Matematiko-Natyrore në Shkup regjistroi 27 tërmete midis pesë dhe tetë shkallëve të intensitetit²⁷ mes viteve 2013 dhe 2017. Maqedonia e Veriut është gjithashtu e prirë për përmytje, shembje të dheut, rrëshqitje të tokës, thatësira dhe stuhi. Janë rritur valët e nxehtësisë, që janë shkas i mungesës së ujit dhe zjarreve të pyjeve, ndërsa ashtu siç vazhdojnë të rriten temperaturat, parashikohet që ngjarjet ekstreme të bëhen edhe më intensive. Ndonëse reshjet mesatare ka të ngjarë të ulen, përsëri reshjet shkatërruese ka mundësi të bëhen më ekstreme. Përkundër kësaj, RPSH 2019²⁸ nuk vëren përparime në mbrojtjen civile. Përderisa rreziku i përmytjes dhe hartat e rrezikut janë zhvilluar për pothuajse të gjitha mjediset, vendi ende nuk ka veprim të efektshëm, të koordinuar

dhe efikas të zbutjes së fatkeqësive dhe reagimit ndaj katastrofave në të gjitha nivelet.

Ndotja e ajrit, kryesisht për shkak të djegies së drurit, trafikut dhe industrisë, është në nivele të larta të rrezikshmërisë në zonat e populluara dhe industriale në të gjithë vendin. Mungesa e burimeve financiare është ende pengesa kryesore për të vendosur masa për përmirësimin e cilësisë së ajrit. Shqetësime të tjera mjedisore përfshijnë mbeturinat e patrajtuara të minierave, mbeturinat komunale dhe industriale që futen në sistemet e ujit, që ndikojnë potencialisht në ujin e pijshëm. Fëmijët që jetojnë në vendbanimet rome mund të jenë në rrezik të veçantë nga uji i patrajtuar dhe mungesa e strategjive për menaxhim të mbeturinave.

Burimi kryesor i energjisë i Maqedonisë së Veriut është qymyri me cilësi të ulët, i cili është edhe jo i rinovueshëm dhe ndotës. Hidrocentralet aktualisht përbëjnë rreth 30 për qind të kapacitetit të energjisë elektrike të vendit, por zvogëlimet e reshjeve të shiut të ndikuara nga ndryshimet klimatike kërcënojnë shfrytëzimin e hidrocentraleve në planin afatgjatë, ndërsa prodhimi i energjisë elektrike nga era dhe dielli është ende në fazën fillestare. Qasja e kufizuar në burime të pastra të energjisë siç është energjia elektrike ose gazi (natyror), veçanërisht kur kombinohet me temperaturat ekstreme, gjithashtu kontribuon fuqimisht në ndotjen e ajrit.

Për shkak të vendndodhjes së saj në rrugën e Ballkanit Perëndimor, Maqedonia e Veriut e administroi transitin e mbi 750,000 migrantëve në 2015, bazuar kjo në të dhënat e UNHCR-së. Megjithëse masat fillestare ishin disi kaotike, institucionet vendore dhe nacionale dëshmuar një kapacitet operativ befasues, megjithëse u shpreh disa shqetësime²⁹ në lidhje me dështime të rëndësishme, me qëllim që të sigurohet drejtësi madje edhe zbatim të ligjit ndërkombëtar për migrantët. Përderisa janë në rrjedhë e sipër disa reforma të legjisllacionit, politikave dhe shërbimeve për azilin dhe migracionin, vendi ende duket i papërgatitur për një fluks të ngjashëm të një valë tjetër të migrantëve, nëse do të ndodhte në të ardhmen e afërt.

25 North Macedonia 2019 Report European Commission op cit.

26 Molyneux N. Climate Landscape Analysis for Children in Macedonia UNICEF (2018) Skopje

27 Cituar në Regjistrin vjetor i statistikës së Republikës së Maqedonisë, 2018 SSO faqe 37. Shkalla e intensitetit të tërmetit është matur në Shkallën Evropiane Makro-Sizmike (EMS-1998) prej 12 gradë të përgatitur dhe propozuar për t'u përdorur në Evropë nga Komisioni Evropian Sizmologjik. 12 shkallët maten sipas efekteve të mëposhtme: a) Efektet tek njerëzit; b) Efektet në objektet dhe natyrën (përveç prishjes së ndërtesave dhe tokës); c) Prishja e strukturave I. Nuk është ndjerë; II. Mezi është ndjerë; III. Është i dobët; IV. Tërmet i vëzhguar gjerësisht; V. Tërmet i fortë; VI. Tërmeti që provokon dëme të vogla; VII. Tërmeti që provokon dëme; VIII. Tërmeti që provokon dëme të mëdha; IX. Tërmeti shkatërrues; X. Tërmet shumë shkatërrues; XI. Tërmet shkatërrimtar; XII. Tërmet tërësisht shkatërrues.

28 Maqedonia e Veriut 2019 Raporti i Komisionit Evropian (maj 2019) Bruksel, në vijim RPSH 2019

29 Shihni për shembull BTI 2018 Country Report — Macedonia Bertelsmann Stiftung (2018) Gütersloh



e. Profili i gjinor

Maqedonia e Veriut ka një Indeks të Pabarazisë Gjimore IPGJ³⁰ (GII) me vlerë 0.149, duke e renditur atë në vendin e 35-të nga 160 vendet në indeksin e vitit 2017. E drejta për barazi midis burrave dhe grave është e mishëruar në Kushtetutë dhe është e mbështetur nga një kornizë e fortë legjislative. Qeveria ka miratuar një plan nacional veprimi për barazinë gjimore (2018-2020) mirëpo zakonet, traditat dhe stereotipat diskriminuese janë akoma të përhapura dhe i minojnë të drejtat themelore të grave.

Struktura gjimore në arsimin fillor dhe të mesëm është relativisht e barabartë edhe pse numri i nxënësve femra që vazhdojnë në nivelin sipëror është në rënie. Me kalimin e viteve, është vërejtur një rritje e numrit të femrave që regjistrohen dhe e mbarojnë universitetin, mirëpo paragjykimi gjinor është i dukshëm në numrin e lartë të femrave të diplomuara në shkencat shoqërore, humane dhe

shkencat mjekësore, ndërsa në shkencat teknike dhe teknologjike numri i femrave të diplomuara është më i ulët në krahasim me studentët meshkuj³¹.

Shkalla e punësimit të grave (34.6%) është në masë të konsiderueshme më e ulët nga ajo e burrave (53.6%), ndërsa jazi ndërmjet shkallës së aktivitetit ekonomik të grave (44.3%) dhe burrave (69.3%) është edhe më i madh³². Paragjykimi gjinor dhe përfaqësimi më i madh i grave në tregun joformal të punës ka tendencë për t'i mbajtur pagat e ulëta të grave - 39.2 për qind e grave të punësuar në sektorin privat fitojnë paga më të ulëta se burrat³³. Vetëm 26 për qind e kompanive kanë një menaxhere grua dhe vetëm 16 për qind janë në pronësi të grave³⁴. Meqenëse prona zakonisht regjistrohet në emrin e burrit ose të një të afërmi mashkull, vetëm 17 për qind e pronave kanë një grua si pronare ose bashkëpronare. Kjo shkallë e ulët e pronësisë së femrave e kufizon përdorimin produktiv të pasurive të grave dhe e rrit vështirësinë

30 The 2010 HDR prezantoi IBGJ, e cila pasqyron pabarazitë gjimore në tre dimensione - shëndetin riprodhues i cili matet nga vdekshmëria e nënave dhe niveli i lindjeve të adoleshentëve; fuqizimi i cili matet nga pjesa e posteve parlamentare të mbajtura nga gratë dhe arritja në arsimin e mesëm dhe të lartë për secilën gjini; dhe aktiviteti ekonomik i cili matet me shkallën e pjesëmarrjes së tregut të punës për gra dhe burra. Për më shumë detaje mbi IBGJ, ju lutemi shikoni Shënimin Teknik 4 në http://hdr.undp.org/sites/all/themes/hdr_theme/country-notes/MKD.pdf Kjo do të thotë që grupimi merr njësoj në konsideratë pabarazinë në favor të burrave ose grave në mënyrë të barabartë.

31 Ibid

32 Ibid

33 Maqedonia e Veriut 2019 Raporti i Komisionit Evropian op cit.

34 Të dhëna për Mojsoska-Blazevski N. Petreski M. and Ayhan O. National Research on Low Female Labour-Market Participation in Macedonia: Quantitative-Based Estimates from a New Survey UN Women (2017) Skopje available at <http://eca.unwomen.org/en/digital-library/publications/2017/06/national-research-on-low-female-labour-market-participation> cituar në COUNTRY PARTNERSHIP FRAMEWORK FOR THE REPUBLIC OF NORTH MACEDONIA 2019 – 2023 Banka Botërore (2018) op cit.

e qasjes së tyre në financa. Në sektorin publik, ku gratë përfaqësojnë më shumë se 50 për qind të forcës së punës, nuk ka asnjë ndryshim në pagat midis grave dhe burrave, por gratë kanë prirje të punojnë në sektorë dhe poste me më pak paga.

Përtej tregut të punës, pjesëmarrja e grave në aksione kolektive është e kufizuar, stereotipat gjinore janë të përhapura, ndërsa dhuna në familje është e zakonshme. Komiteti për eliminimin e diskriminimit ndaj grave vuri në dukje në përgjigjen³⁵ e tyre ndaj Raportit Kombëtar në vitin 2018 se mbretërimi i stereotipave të vjetruara gjinore në familje, në sistemin arsimor dhe në shoqëri përbëjnë kërcënimin më të madh për barazinë e grave në Maqedoninë e Veriut. Studimi i HECJ-së³⁶ në vitin 2016 zbuloi se hendeku midis kontributit të grave dhe burrave në detyrat shtëpiake në Maqedoninë e Veriut është ndër më të lartat në Evropë - 71/10 orë në javë në krahasim me mesataren e BE-së prej 79/34. Ashtu si në shumë vende, gratë kanë një ngarkesë më të madhe kur bëhet fjalë për balancimin e kërkesave të punës me ato jashtë vendit të punës. Politika e qeverisë mund të ketë nevojë ta rishikojë fleksibilitetin, ose mungesën e fleksibilitetit brenda orarit të punës, por gjithashtu duhet të ketë një ndryshim të rëndësishëm në marrëdhëniet gjinore


për të arritur ndonjë përmirësim të rëndësishëm në jetën e grave.

f. Financat publike

Buxheti i pamjaftueshëm paraqet pengesë të madhe në procesin e implementimit. Megjithëse tani Maqedonia e Veriut ka arritur të jetë një vend me të ardhura të mesme, ajo akoma ndan proporcionalisht më pak mjete buxhetore në sektorët për fëmijëve, për dallim me vendet ekuivalente në rajonin e Evropës Lindore dhe Azisë Qendrore EAQ (ECA). Urgjentisht nevojitet një analizë e plotë e proceseve të buxhetimit të Maqedonisë së Veriut, me fokus në fëmijët, e cila bën vlerësimin e ndarjes së fondeve dhe shpenzimet. Një studim³⁷ lokal ka llogaritur që fondet totale të buxhetit të dedikuara për programet për fëmijë në vitin 2018 kanë qenë 22.976 milion denarë, ose 374 milion euro. Kjo paraqet një rritje absolute prej 42 për qind në krahasim me vitin 2010, mirëpo kur llogaritet si një pjesë e BPV-së, alokimet në programet për fëmijë kanë rënë nga 3.6 për qind në viti 2010 deri në 3.2 për qind BPV në vitin 2017, dhe 10.2 për qind të shpenzimeve të përgjithshme.

Gjithashtu ngre disa shqetësime edhe efektiviteti i kostos së modeleve aktuale të shpenzimeve që kanë të bëjnë me fëmijët. Fondet e qeverisë në

Shkalla e punësimit të grave (34/6%) është në masë të konsiderueshme e ulët në raport me burrat (53.6%).



35 Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit kundër Grave (2019) op cit.

36 Eurofound (2019) op cit.

37 Finance Think Policy Brief No.30 (2018) op cit.

disa raste duket se po subvencionojnë fitues më të lartë, në vend se t'i mbështesin familjet në nevojë p.sh. subvencione për kopshte dhe pagesa të asistencës prindërore. Këto raste ngritin dilema në lidhje me planifikimin, buxhetimin dhe proceset e vendimmarrjes në përgjithësi, dhe cilësinë e të dhënave në të cilat mbështeten. Disa fusha si shëndeti dhe arsimit janë hulumtuar mirë, andaj kanë baza solide dhe procese të mbledhjes së të dhënave, ndërsa grupet e cenueshme si fëmijët me aftësi të kufizuara ose fëmijët romë gjithmonë duket se nuk i kanë të dhënat e nevojshme në formatin e kërkuar. Zhvillimi afatgjatë dhe kostot e mundësive dhe përfitimet e shërbimeve të veçanta rrallëherë kanë ndikim në planifikim, ndërsa gjithashtu duket se mungon aftësia e për modele alternative të kostos.

Shqyrtimet e pavarura³⁸ tregojnë një seri komplekse sfidash, të cilat ndikojnë negativisht në zhvillimin e shërbimeve dhe ofrimin e tyre në nivelin lokal. Shumë komuna nuk janë në gjendje t'i financojnë funksionet e tyre themelore, andaj ngelin të pa financuara shërbimet kyçe që kanë të bëjnë me fëmijët, siç është rasti me arsimin. Të ardhurat nga taksat dhe tarifatat lokale përfaqësojnë rreth një të tretën e të ardhurave të qeverisjes vendore, andaj çekuilibrimi fiskal është i përmbushur me transferime nga pushteti qendror. Bllok donacionet arrijnë rreth 80 për qind të këtyre transferimeve dhe rreth 49 për qind të të ardhurave totale të komunave, mirëpo vlera e tyre si përqindje e BPV-së ka shënuar rënie, ndërsa niveli aktual i financimit që ata ofrojnë është i papërshtatshëm. Edhe pse ka pasur disa rritje në mbledhjen e taksave dhe tarifave lokale, kjo nuk e ka ruajtur ritmin me transferimin e përgjegjësisë për shpenzimet në nivelin lokal.

Po ashtu ekzistojnë probleme me formulat e shpërndarjes së granteve, përfshirë transparencën e llogaritjeve dhe procesin e zgjedhjes se cilat komuna do t'i marrin mjetet e transferuara. Sistemi aktual i transferimeve nuk duket se i adreson pabarazitë sociale dhe ekonomike, të cilat ekzistojnë midis komunave për shkak të vendndodhjes, madhësisë së popullsisë etj. Veçanërisht në pozitë të pafavorshme janë komunat rurale dhe të vogla me baza të vogla

tatimore lokale. Për shembull, aktualisht komuna me më shumë fonde ka gjashtë herë më shumë të ardhura nga ajo me më pak fonde. Sistemi i transferimit duhet të jetë në gjendje t'i zbus këto pabarazi, por aktualisht bën pak punë për t'i zgjidhur pabarazitë, me çka i konfirmon dhe përforcon boshllëqet në qasjen e fëmijëve në të drejtat e tyre themelore. Veprimet e ekuilibruara në disa dimensione janë të domosdoshme për t'i adresuar këto boshllëqe, duke përfshirë ndërtimin e kapacitetit për mbledhjen e fondeve, qasjen në to, thithjen dhe shfrytëzimin e fondeve, si dhe bashkëpunimin ndërmjet komunave për t'i shkëmbyer dhe konsoliduar shërbimet. Për shkak të këtyre pabarazive, rritja e autonomisë së të ardhurave lokale në Maqedoninë e Veriut nuk do ta përmirësojë vetvetiu efikasitetin e shpenzimeve. Pra duhet zhvilluar metoda të thjeshta dhe transparente për t'i llogaritur nevojat e shpenzimeve, të cilat ndërlidhen me përgjegjësitë funksionale siç është arsimit ose më gjerësisht grupet specifike të popullsisë siç janë fëmijët. Në fakt, kërkohet buxheti për fëmijët për secilën komunë i bazuar në një vlerësim tërësor të nevojave të fëmijëve në secilën zonë.

g. Varfëria

Shkalla e varfërisë në Maqedoninë e Veriut ka mbetur vazhdimisht e lartë. Në vitin 2017, shkalla e varfërisë relative e Maqedonisë së Veriut ka qenë 22.2 për qind, mirëpo Enti Shtetëror i Statistikës (ESHS) ka përlogaritur³⁹ se 41.9 për qind e popullsisë ka qenë në rrezik të varfërisë ose përjashtimit social, kurse 30 për qind kanë qenë materialisht të privuar, që është numër më i lartë se çdo vend fqinj ose vend i BE-së 28.

Fëmijët janë në rrezik të lartë të varfërisë në Maqedoninë e Veriut. Kur gjykohet në bazë të karakteristikave të amvisërisë, shkalla e varfërisë ka qenë më e ulëta (5.7%) në amvisëritë me një person të rritur, 65 vjeç ose më të vjetër, dhe 14.2 për qind për familjet pa fëmijë të varur nga prindërit. Sidoqoftë, ky numër është rritur në 26 për qind për amvisëritë me fëmijë të varur (nga prindërit) dhe në 37.5 për qind për amvisëritë e prindërve të vetëm me fëmijë të varur. Shkalla më e lartë e varfërisë deri tani (51.25%) ishte për amvisëritë me tre ose

38 North Macedonia Public Finance Review: Sowing the Seeds of a Sustainable Future. World Bank. (2018) op cit.


39 Zhvillimi i Qëndrueshëm 2018 SSO (2018) Shkup f.70-77

më shumë fëmijë⁴⁰. Bazuar në Sondazhin mbi të Ardhurat dhe Kushtet e Jetesës SAKJ (SILC)⁴¹, Enti Shtetëror i Statistikës ka llogaritur, që niveli i rrezikut të varfërisë në Maqedoninë e Veriut ka qenë 22.2 për qind në 2017, por kjo përqindje është gati 30 % për djemtë dhe vajzat e moshës 0-17 vjeçare, që paraqet shifër më të lartë se çdo grup moshë tjetër.

Shkalla e përgjithshme e papunësisë ka rënë pak nga 26 për qind në 2015 në 21 për qind në 2018. Sidoqoftë, shkalla e papunësisë për personat e moshës 15-19 vjeçare ka qenë 58 për qind në vitin 2017 dhe 45 për qind⁴² për moshat 20-24 vjeçare. Papunësia është një kontribuues kryesor i varfërisë në Maqedoninë e Veriut edhe pse punësimi nuk garanton çlirim nga varfëria për çdo amvisëri. Ka një sërë çështje domethënëse për tu adresuar rreth pagave të ulëta, pasigurisë së punës dhe shkallës së lartë të punësimit joformal, që vlerësohet të jetë në 18.1 për qind në 2017⁴³.

Maqedonia e Veriut është një shoqëri e pabarabartë me një nga koeficient⁴⁴ më të lartë të Gini (32.5) në rajonin e Evropës dhe Azisë Qendrore. Vlera Indeksit të Zhvillimit Njerëzor IZHNJ (HDI) e vendit për vitin 2018 është 0.759, që e vendos atë në kategorinë e lartë të zhvillimit njerëzor, mirëpo kjo vlerë ka rënë në 0.660 kur vlera IZHNJ-ja shënon rënie për shkak të pabarazisë dhe humbjes prej 13.1 për qind. Ndonëse statistikatat zyrtare të mirëqenies së grupeve etnike nuk janë të disponueshme, sipas disa dëshmime⁴⁵ pakicat etnike janë më të varfra se popullata e përgjithshme. Familjet etnike shqiptare përbëjnë më shumë se 40 për qind të kuintilit më të varfër, me të ardhura të disponueshme të vetëm dy të tretave të bashkëmoshatarëve të tyre maqedonas, ndërsa popullsia rome jo vetëm që është e përqendruar në 40 përqindëshin e poshtëm, por është gjithashtu shumë më poshtë se grupet e tjera etnike në rezultatet e tregut të punës, kapitalit njerëzor dhe treguesve tjerë jo-monetarë të varfërisë.

Shkalla më e lartë e varfërisë (51.25%) në masë të madhe haset të amvisëritë me më shumë se tre fëmijë.



40 Ibid

41 Zhvillimi i Qëndrueshëm 2018 SSO (2018) Shkup f. 70-77. Burimi i përlogaritjes së varfërisë janë të ardhurat dhe pragu i varfërisë i definuar në 60% të mesatares së të ardhurave

42 Regjistri vjetor i statistikës i Republikës së Maqedonisë the, 2018 SSO op cit. Kapitulli 07 Tregu i punës

43 Maqedonia e Veriut 2019 Raporti i Komisionit Evropian op cit.

44 Ky tregues i pabarazisë përcaktohet si një raport i të ardhurave totale të marra nga 20% e popullsisë me të ardhurat më të larta (kuintil të lartë) me atë të marrë nga 20% e popullsisë me të ardhurat më të ulët (kuintil më e ulët). Të ardhurat paraqesin të ardhura ekuivalente të disponueshme.

45 Sondazhi i Cilësisë së Jetës në Maqedoni është zhvilluar në periudhën maj-qershor 2017. Sondazhi është hartua nga një tink-tank Financial Think dhe përfshinte si individët po ashtu edhe amvisëritë. Ai mblodhi të dhëna për demografinë, kushtet socio-ekonomike, konsumin, të ardhurat dhe treguesit e tregut të punës, midis fushave të tjera. Shih <http://www.financethink.mk/models/survey-on-quality-of-life-in-macedonia-2017/> Citohet në Seizing a Brighter Future for All Former Yugoslav Republic of Macedonia Systematic Country Diagnostic World Bank Group (2018) Uashington



h. Analizat sektoriale

Një ekzaminim tematik i kujdesit dhe zhvillimit në fëmijëri të hershme në kuadër të sektorëve të arsimit, shëndetësisë dhe mbrojtjes tregon përparim real në të gjithë sektorët që nga viti 2015, mirëpo shumica e këtyre pengesave ende e bllokojnë ofrimin e shërbimeve cilësore për gratë dhe fëmijët. Përpjekjet e njëpasnjëshme të qeverive për t'i forcuar kornizat legjislative, politike dhe ato të planifikimit, të ndërlidhura me fëmijët kanë, çuar në rritje të konsiderueshme të numrit absolut të fëmijëve dhe familjeve që kanë qasje në të drejtat e tyre gjatë dy dekadave të fundit. Mirëpo investimi në shëndetësi, arsim dhe mbrojtje nuk e ka ruajtur ritmin e rritjes ekonomike, madje ekzistojnë mekanizma të pamjaftueshëm për të siguruar që planifikuesit e shërbimeve sektoriale t'i tejkalojnë barrierat strukturore të qasjes. Për këtë arsye ofrimi i shërbimit ka tendencë të jetë disi i rregullt në të gjithë vendin dhe pa dashje t'i diskriminojë kategoritë më vulnerable. Ofrimi i shërbimeve në çdo sektor pengohet nga mungesa e investimeve; përdorimi joefektiv i burimeve të disponueshme; personeli i pamjaftueshëm dhe morali i dobët i personelit; koordinim i kufizuar ndërmjet

sektorëve; ndjekja jo-konsistence e parimeve të transparencës, përgjegjshmëria dhe planifikimi i mirë; dhe mungesa e një shoqërie civile të fortë e të përqendruar në fëmijën, e cila mund të bëjë që palët përkatëse të japin llogari dhe të kërkojë shërbime cilësore për fëmijët dhe amvisëritë.

(i) Edukimi në fëmijëri të hershme

Regjistrimi në edukimin parashkollor të fëmijët e moshës 3 deri në 6 vjeç është rritur nga 21.8 për qind në 2007 në 35.5 për qind në vitin 2017⁴⁶, mirëpo shkalla e pjesëmarrjes mbetet e ulët në krahasim me vendet fqinje - Shqipëria (81 për qind), Mali i Zi (56 për qind) dhe Serbia (40 për qind) - dhe shumë më poshtë se mesatarja në të gjithë vendet e OECD (95 për qind)⁴⁷. Me vetëm rreth 30 për qind të fëmijëve, që ndjekin institucionet e licencuara parashkollorë në vitin shkollor 2018/2019⁴⁸, regjistrimi akoma është ende nën objektivin e BE-së për edukim dhe trajnim për vitin 2020 që është 95 për qind. Sidoqoftë, Strategjia aktuale gjithëpërfshirëse për arsimin parashikon krijimin e një viti të detyrueshëm të arsimit parashkollor për fëmijët e moshës 5-6 vjeçare, në mënyrë që të sigurohet që fëmijët të hyjnë në shkollë të përgatitur mirë.

46 Shih bazën e të dhënave TransMonEE në http://www.stat.gov.mk/TransMonee_en.aspx

47 Republic of Macedonia - Teacher Education Programme on Early Numeracy and Literacy in the former Yugoslav Republic of Macedonia. OECD (2018) gjendet në <http://www.oecd.org/education/ceri/UNICEF.MCD.SystemNote.pdf> cituar në OECD (2019) op cit

48 North Macedonia 2019 Report European Commission op cit.

Me vetëm rreth 30 për qind të fëmijëve, të përfshirë institucionet e licencuara parashkollore në vitin 2018/2019, regjistrimi i fëmijëve ende është më i ulët se caku i BE-së për arsim dhe trajnim me 95 për qind.



Gjithashtu qeveria ka ndërmarrë masa për t'i rritur burimet dhe godinat parashkollore duke investuar në infrastrukturën parashkollore dhe në trajnimin e cilësisë së lartë të arsimtarëve parashkollorë. Këto reforma duhet të ndihmojnë në adresimin e ndryshimeve ekzistuese të kompetencave themelore të fëmijëve, kur hyjnë në shkollë fillore, gjë që pjesërisht reflekton pjesëmarrjen e ulët në institucionet parashkollore.

Përderisa shumica e prindërve shprehin admirim për përfitimet e edukimit të hershëm për zhvillimin e fëmijës, punësimi duket të jetë faktori kryesor për zgjedhjen e opsioneve të kujdesit të fëmijëve. Çështjet e cilësisë për të cilat prindërit duken më të shqetësuar janë proporcioni fëmijë/ofrues të shërbimeve, (68.3 për qind), përvoja e ofruesve të kujdesit për fëmijë (60.5 për qind), marrëdhënia me ofruesin e shërbimeve të tilla (62.4 për qind) si dhe vendndodhja dhe kostoja e transportit (51.2 për qind).

Megjithëse arsimi parashkollor është kryesisht publik, me 98 për qind të fëmijëve që i ndjekin institucionet publike parashkollore, më pak se 1 për qind e tyre nga kuintili më i varfër ndjekin

edukimin parashkollor krahasuar me 55.9 për qind të fëmijëve nga kuintili më i pasur⁴⁹. Të gjithë prindërit, pavarësisht nga të ardhurat e amvisërisë, duhet të mbulojnë rreth 21 për qind të kostos së programeve parashkollore (25 € në muaj), gjë që paraqet një pengesë shtesë për familjet me të ardhura të ulëta⁵⁰, kështu që familjet me përparësi socio-ekonomike, të cilat mund t'i përballojnë pagesat e shërbimeve parashkollore kanë më shumë të ngjarë të përfitojnë burimet publike. Prindërit e vetëm, prindërit e fëmijëve me nevoja të posaçme dhe prindërit e papunë kanë më pak të ngjarë të përdorin shërbime të kujdesit për fëmijë. Ekzistojnë gjithashtu pabarazi rajonale dhe urbane/rurale për sa i përket qasjes dhe mundësisë. Në vitin 2016, pjesa e fëmijëve të moshës 0–5 vjeçare në kopshtet e fëmijëve ishte rreth 32 për qind për rajonin e Lindjes dhe atë të Pellagonisë, por vetëm 8 për qind për Verilindjen⁵¹. Pjesëmarrja në arsimin parashkollor është gjithashtu e ulët në grupet e pakicave. Mbi gjysma e fëmijëve maqedonas vijojnë arsimin parashkollor, krahasuar me më pak se një në pesë fëmijë shqiptarë. Vetëm 2.6 për qind e fëmijëve katërvjeçarë nga komunitetet rom ndjekin arsimin parashkollor⁵².

49 OECD (2019) op cit

50 World Bank North Macedonia Public Finance Review: Sowing the Seeds of a Sustainable Future op cit

51 Ibid

52 World Bank, Former Yugoslav Republic of Macedonia - SABER Country Report op cit.



(ii) Arsimi fillor

Kohëzgjatja e arsimit të detyrueshëm në Maqedoninë e Veriut është më e larta në rajon - 13 vjet. Pjesa dërrmuese e nxënësve ndjekin mësimin në shkolla publike. Strategjia gjithëpërfshirëse e arsimit për periudhën 2018-2025 e miratuar në vitin 2018 përcakton veprimet kryesore për ta përmirësuar përvojën e mësimin të fëmijëve - rritjen e përfshirjes së fëmijëve në edukimin parashkollor dhe detyrimin për një vit obligativ të arsimit parashkollor; zhvillimin e udhëzimeve të përqendruara tek nxënësit duke reformuar kurikulat dhe programet për ta rritur rëndësinë dhe përafrimin me fazat e zhvillimit të fëmijëve; matjen e të mësuarit nën frymën e rezultateve dhe jo thjesht përvetësimin e njohurive; dhe prezantimin e një kornize nacionale të vlerësimit (notimit). Sidoqoftë, dokumentet strategjikë nuk përcaktojnë ndonjë synim specifik për sektorin dhe nuk ka synime të përcaktuara për t'i rritur rezultatet e mësimin. Sistemet e të dhënave të pazhvilluara dhe të pashfrytëzuara pengojnë zhvillimin e politikës së bazuar në prova.

Shpenzimet publike për arsimin para-universitar në Maqedoninë e Veriut janë shumë më të ulëta se mesatarja e OECD-së⁵³ dhe më pak se shumica

e vendeve të kategorisë së njëjtë. Midis viteve 2011 dhe 2016 shpenzimet publike për arsimin si përqindje e BPV-së ka ranë nga 4.6 për qind në 3.7 për qind⁵⁴, madje ka ranë nga 13.3 për qind në 11.6 për qind si një pjesë e shpenzimeve totale të qeverisë. Por më e rëndësishmja⁵⁵ është se analiza tregon që vendet me shpenzime mesatarisht të ngjashme kanë arritur afër 34 për qind (112 pikë) më shumë në testet PISA. Përdorimi i tanishëm i burimeve të disponueshme dhe mungesa e mekanizmave të mbikëqyrjes janë disa nga arsytet e ndikimit të kufizuar pozitiv të shpenzimeve për arsimin e Maqedonisë së Veriut.

Shumë shkolla kanë mungesë të burimeve themelore, andaj hulumtimi⁵⁶ i OECD sugjeron që nevojitet të sigurohen standardet minimale për të arritur një arsimi me cilësi të lartë. Numri i madh i shkollave të vogla dhe proporcioni i madh ndërmjet numrit të nxënësve dhe arsimtarëve tregon hapësirë të konsiderueshme për t'i përdorur burimet në mënyrë më efektive. Përderisa proporcioni mesatar nxënës-arsimtarë (13.8) është i ngjashme me mesataren e OECD-së (13.1), megjithatë hasen ndryshime të gjera nëpër komuna. Proporcionet e ulëta mes arsimtarëve dhe nxënësve reflektojnë pjesërisht nevojën për t'u kujdesur për një organ shumëgjuhësh të nxënësve, mirëpo padyshim që

53 Education at a Glance 2017: OECD Indicators. OECD (2017) Pari available at <http://dx.doi.org/10.1787/eag-2017-en>

54 World Bank North Macedonia Public Finance Review: Sowing the Seeds of a Sustainable Future op cit

55 Ibid

56 OECD PISA 2015 Results (Volume I): Excellence and Equity in Education OECD (2016) op cit

forca punëtore e arsimtarëve mund të menaxhohet në mënyrë më efektive me qëllim që të përputhet me numrat e nxënësve. Ndonëse ka pasur një rënie prej 10 për qind të numrit të nxënësve që nga viti 2007, numri i arsimtarëve është rritur për 10 për qind, ndërsa numri i orëve ka ngel i pandryshuar. Për më tepër, pagat e mësuesve janë rritur pa ndonjë përmirësim përkatës në produktivitet ose cilësi.


Tani Maqedonia e Veriut e ka përmbushur kriterin e regjistrimit "të plotë" në shkollë fillore, mirëpo fëmijët me aftësi të kufizuara dhe ata nga komunitetet rome vazhdojnë të përballen me pengesa për qasje në arsim dhe trajnim të rregullt dhe cilësor. Përkundër niveleve të larta të përfundimit të përgjithshëm të arsimit fillor dhe të mesëm, rreth⁵⁷ 10 për qind e fëmijëve nga komunitetet rom nuk e ndjekin rregullisht mësimin në shkollë fillore. Sidoqoftë ndryshon shkalla e regjistrimit dhe e pjesëmarrjes në nivele të tjera të shkollimit. Regjistrimi bruto në shkollën e mesme mbetet më shumë se 10 pikë përqindje më e ulët se vendet e tjera të rajonit, gjegjësisht është më i ulët midis nxënësve me prejardhje më të ulët socio-ekonomike dhe atyre që vijnë nga në zonat rurale⁵⁸. Ligji i ri për arsimin fillor përcakton që fëmijët me aftësi të kufizuara të regjistrohen në shkolla fillore të rregullta, madje

edhe fëmijët migrantë të kenë mundësi të kenë qasje në shkollim. Po ashtu një projekt i ri zhvillon një seri masash për ta mbështetur përfshirjen e të gjithë fëmijëve në shkolla gjatë viti aktual shkollor.

Për sa i përket cilësisë nga të gjitha vendeve pjesëmarrëse në PISA, Maqedonia e Veriut ka një nga proporcionet më të larta të nxënësve (52.2 për qind), të cilët nuk arrijnë të demonstrojnë aftësi themelore në të tre fushat e shkencës, matematikës dhe leximit. Më shumë se tre prej pesë nxënësve të moshës 15-vjeçare iu mungon aftësia themelore e leximit (70.7 për qind) e matur nga PISA, krahasuar me 50 për qind në Shqipëri dhe 42 për qind në Mal të Zi, madje për dallim nga këto vende, pjesa e nxënësve me rezultate të dobëta në Maqedoninë e Veriut është rritur me afro shtatë pikë përqindje ndërmjet viteve 2000 dhe 2015⁵⁹. Një vlerësim i USAID-it për mësimin e nxënësve në vitin 2016⁶⁰ zbuloi se më pak se 40 për qind e tyre në klasën e dytë i kanë përfunduar detyra për lexim me kuptim, krahasuar me një standard ndërkombëtar prej 80 për qind.

Shkollat ofrojnë kohë të kufizuar mësimore. Deri në moshën 14 vjeçare nxënësit në Maqedoninë e Veriut kalojnë gati 900 orë më pak mësim sesa nxënësit në vendet e tjera të OECD-së.

Tre nga pesë fëmijë 15 vjeçarë kanë ngecje në njohuritë themelore për lexim.



57 North Macedonia 2019 Report European Commission op cit

58 World Bank Improving the Efficiency of Education Spending to Enhance Skills Development quoted in OECD (2019) op cit. See also Seizing a Brighter Future for All Former Yugoslav Republic of Macedonia Systematic Country Diagnostic World Bank (2018) op cit.

59 OECD PISA 2015 Results (Volume I): Excellence and Equity in Education OECD (2016) Paris available at <http://dx.doi.org/10.1787/9789264266490-en>

60 Kjo e përfshin Early Grade Reading Assessment (EGRA) dhe Early Grade Mathematics Assessment (EGMA). Shih USAID. (n.d.). Main findings and recommendations from the nationwide assessment of reading and numeracy skills in early grade students quoted in OECD (2019) op cit.

Një pengesë për rritjen e kohës mësimore në Maqedoninë e Veriut është shtrirja e lartë e shkollave me dy turne. Ekzistojnë gjithashtu dëshmi⁶¹ që arsimtarëve iu mungojnë mjetet për t'i zbuluar dhe diagnostikuar nevojat mësimore të nxënësve, madje të dhënat e PISA 2015⁶² tregojnë se edhe nëse arsimtarët arrijnë t'i zbulojnë dhe diagnostikojnë nevojat mësimore të nxënësve, në të shumtën e rasteve arsimtarët kanë mungesë të hapësirave për të ofruar udhëzime shtesë. Në veçanti kjo haset në shkolla me më shumë turne (ndërrime).

Ekziston një shqetësim se arsimi inicial i arsimtarëve nuk i pajis në mënyrë adekuate arsimtarët e rinj me kompetenca të duhura mësimore. Regjistrimi në fakultetet pedagogjike në nivelin universitar nuk është sa duhet selektiv, andaj përderisa kandidatët për mësues kanë një praktikë mësimore në një shkollë, ata shpesh nuk trajnohen nga mentorët, arsimtarët me përvojë. Mungesa e mekanizmave të fortë për certifikimin inicial do të thotë që mësuesit e rinj mund të hyjnë në profesion pa ndonjë siguri se ata i kanë përmbushur kompetencat minimale të mësimdhënies. Mësuesit në Maqedoninë e Veriut gjithashtu bëjnë pjesë në grupin e arsimtarëve me më pak zhvillim profesional sesa në shumë vende të tjera.

Në suaza të vendeve⁶³ pjesëmarrëse në PISA shkollat në Maqedoninë e Veriut bëjnë pjesë ndër shkollat më pak të ndara sipas statusit socio-ekonomik, por kjo në një masë të madhe e reflekton faktin që të gjithë nxënësit në vend, pavarësisht prejardhjes socio-ekonomike, arrijnë nivele të ulëta të rezultateve të të nxënësve. Në realitet, vazhdojnë të ekzistojnë pabarazi të mëdha, andaj fëmijët nga komunitetet pakicë dhe fëmijët me aftësi të kufizuara janë akoma më pak të predispozuar të

kenë arsim cilësor dhe të përparojnë me sukses në kuadër të sistemit arsimor. Nxënësit me prejardhje të pafavorshme kanë më pak të ngjarë të regjistrohen në arsimin e mesëm, madje kanë tri herë më shumë të ngjarë të regjistrohen në një program para arsimit profesional ose në program mësimor profesional, sesa bashkëmoshatarët e tyre të cilët jetojnë në kushte më të favorshme. Nxënësit në drejtimet profesionale kanë tendencë të arrijnë rezultate më të ulëta në Maturën shtetërore, mirëpo ndryshe nga shumë vende të OECD, nxënësit e drejtimeve profesionale kanë mundësi të barabartë për vijim të studimeve në arsimin sipëror.

Për sa i përket kategorisë gjinore në Maqedoninë e Veriut djemtë arrijnë rezultate më të ulëta, siç është rasti edhe në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Vajzat i tejkalojnë djemtë në shkencë me 20 pikë, ndërsa në lexim kanë avantazh prej 46 pikësh⁶⁴. Maqedonia e Veriut ka një hendek të madh të suksesit mbi bazën e vendbanimeve rurale-urbane në krahasim me vendet e tjera pjesëmarrëse në PISA. Në fakt nxënësit në zonat rurale arrijnë 47 pikë më pak se bashkëmoshatarët e tyre në shkencë (krahasuar me një diferencë mesatare të OECD prej 17 pikësh)⁶⁵. Gjithashtu pabarazitë vazhdojnë edhe midis grupeve etnike. Përderisa shqiptarët përfaqësojnë afro 25 për qind të popullsisë së përgjithshme, ata përbëjnë vetëm 15.6 për qind të nxënësve në arsimin e mesëm dhe vetëm 5.5 për qind të atyre që regjistrohen në arsimin terciar (universitet)⁶⁶. Nivelet e ulëta të suksesit mund t'i pasqyrojnë kushte të dobëta të të mësuarit, përfshirë nivelin e kualifikimit të mësuesve, në shkollat dhe komunat kryesisht etnike shqiptare⁶⁷. Romët janë 2.2 për qind e popullsisë së përgjithshme, por përfaqësojnë vetëm 0.5 për qind të nxënësve të shkollave të mesme dhe 0.1 për qind të studentëve në universitete⁶⁸.

61 OECD PISA 2015 Results (Volume I): Excellence and Equity in Education op cit.

62 OECD PISA 2015 Results (Volume I): op cit

63 PISA 2015 Results (Volume III): Students' Well-Being OECD (2017) Paris available at <http://dx.doi.org/10.1787/9789264273856-en>

64 OECD PISA 2015 Results (Volume I): op cit.

65 Ibid

66 World Bank. (n.d.). Improving the Efficiency of Education Spending to Enhance Skills Development quoted in OECD (2019) op cit.

67 World Bank. (n.d.). Improving the Efficiency of Education Spending to Enhance Skills Development op cit.

68 OECD (2019) op cit.



(iii) Shëndeti

Kujdesi shëndetësor në Maqedoninë e Veriut sigurohet nga një përzierje e ofruesve publikë dhe privatë të financuar përmes një sistemi ligjor të sigurimit shëndetësor dhe disa pagesave në formë të participimit. Dy institucionet qendrore në sistemin e kujdesit shëndetësor janë Ministria e Shëndetësisë (MSH) dhe Fondi i Sigurimit Shëndetësor (FSSH). Ligji për kujdesin shëndetësor (2015) dhe Ligji për sigurimin shëndetësor (2015) e mbështesin sistemin shëndetësor dhe i përcaktojnë parametrat e organizimit të tij, ndërsa Strategjia nacionale shëndetësore 2020 përbën dokumentin themelor të politikës shëndetësore në vend. Ndonëse Ligji për vetëqeverisjen lokale (2002) parashikon transferimin e përgjegjësisë për ofrimin e kujdesit shëndetësor në nivel lokal, kjo përgjegjësi ende nuk është marrë përsipër nga komunat, andaj pothuajse të gjitha vendimet merren nga Ministria e Shëndetësisë, përfshirë edhe emërimi i drejtorëve të institucioneve lokale të kujdesit shëndetësor publik.

Katër programe nacionale të shëndetit publik përqendrohen në shëndetin e nënës, fëmijëve

dhe adoleshentëve - imunizimin; mbrojtjen aktive shëndetësore të shëndetit të nënës dhe fëmijës; kontrollet sistematike parandaluese të nxënësve; dhe subvencionimin e bashkë-sigurimit për shërbimet e ofruara për nënat dhe foshnjat deri në moshën një vjeçare. Këto veprime kanë kontribuar në rezultate përgjithësisht të favorshme për qasjen dhe përdorimin e shërbimeve për shëndetin e nënave dhe fëmijëve, pavarësisht pabarazive të dukshme rajonale dhe urbane/rurale. Maqedonia e Veriut ende nuk e ka kryer një studim gjithëpërfshirës të konsumit të ushqimit për të vlerësuar konsumimin e fëmijëve nga makro dhe mikronutrientët, por të dhënat nga matjet antropometrike të fëmijëve tregojnë se rreth 39.4 për qind e djemve dhe 32.9 për qind e vajzave janë mbipeshë, dhe 20.3 për qind e djemve dhe 16 për qind e vajzave janë të trashë.⁶⁹

Gjithashtu deri në njëfarë mase është shqetësuese se shërbimet shëndetësore të adoleshentëve mbështeten shumë te sektori vullnetar dhe se janë të pakta të dhënat në lidhje me shëndetin mendor⁷⁰. Prevalenca e HIV-it mbetet e ulët, me një numër të përgjithshëm prej 236 rastesh të regjistruara ndërmjet 1987 dhe 2014, që është niveli i dytë më i ulët i raportuar

69 Instituti i Shëndetit Publik Maqedonisë . Report about the implementation of round 4 of the WHO European Childhood Obesity Surveillance Initiative (COSI) in the Republic of Macedonia. Skopje: IPH; 2017

70 Milevska Kostova N, Chichevalieva S, Ponce NA, van Ginneken E, Winkelmann J. The former Yugoslav Republic of Macedonia: Health system review European Observatory on Health Systems and Policies/WHO (2017) Copenhagen available at <http://www.healthobservatory.eu>

në rajonin e Evropës Juglindore. Sidoqoftë, tendencat e prevalencës duhet të vazhdojnë të monitorohen pasi studimet e sjelljes tregojnë se sjelljet me rrezik të lartë dhe niveli i ulët i njohurive mbi parandalimin e HIV-it janë ende të pranishme në mesin e popullsisë kryesore⁷¹, andaj fëmijët e cenueshëm mund të jenë më shumë të ekspozuar ndaj rrezikut sesa që aktualisht pranohet.

Maqedonia e Veriut është i vetmi vend në mesin e shteteve me standarde të përafërta, në të cilin shpenzimet e shëndetit publik si një pjesë e BPV-së kanë rënë vazhdimisht gjatë 15⁷² viteve të fundit, duke arritur në 4.1 për qind në 2014, shumë më poshtë nga mesatarja e BE-së. Shpenzimet për shëndetin publik përbëjnë 63 për qind të shpenzimeve totale të shëndetit në 2014, që është përsëri më e ulët se mesatarja e BE-së⁷³. Në vitin 2017, Qeveria shpenzoi 65 milion euro për shëndetin e fëmijëve⁷⁴, që në terma realë është një rënie nga 0.68 për qind e BPV-së në 2010 në 0.63% në vitin 2017, në një kohë kur disa tregues shëndetësorë në lidhje me fëmijët kanë shënuar përkeqësime. Shkalla mesatare e imunizimit për fëmijët është ulur nga 94.2 për qind në 2010 në 90.7 për qind në vitin 2017, nga ana tjetër është rritur shkalla e vdekshmërisë së foshnjave nën moshën 5 vjeçare në 12 dhe 13.7 në 1000 lindje të gjalla në vitin 2017, krahasuar me 9.2 dhe 10.4 në vitin 2010.

Zakonisht mjekët amë janë pika kryesore e kontaktit të pacientëve me sistemin e kujdesit shëndetësor. Ministria e Shëndetësisë e ka vënë në funksion specialitetin e mjekësisë familjare në kujdesin primar në vitin 2012. Çdo mjek i kujdesit primar është i detyruar me ligj që të shoqërohet nga një infermiere mjekësore për të formuar një ekip mjekësor, i cili më pas organizon punën e tyre në praktika të vetme ose në grup. Nëse, pas ekzaminimit, ekziston nevoja për shërbime tjera të specializuara ambulatorë, mjeku i përgjithshëm e udhëzon pacientin në nivele më të larta të kujdesit ose në shërbime të specializuara diagnostikuese ose terapeutike. Specialistët mund ta dërgojnë më tej pacientin

në shërbime të tjera. Ofrimi i shërbimit për personat që kanë nevojë për kujdes ose ndihmë të vazhdueshëm mjekësore mbetet i pazhvilluar, andaj kujdesi për këta pacientë në masë të madhe sigurohet nga anëtarët e familjes, zakonisht nga gratë.

Maqedonia e Veriut ka relativisht pak punonjës shëndetësorë për kokë banorë⁷⁵ me 280 mjekë dhe 421 infermierë për 100,000 banorë renditet shumë nën mesataren e BE-së. Numri i pediatërve ka rënë nga 9.54 / 10,000 fëmijë në vitin 2011 në 8.04 / 10,000 fëmijë në 2016⁷⁶. Maqedonia e Veriut ka 17 gjinekologë për 100,000 njerëz, që është më shumë se mesatarja e BE-së, mirëpo totali i mamive dhe infermierëve është pothuajse sa gjysma e mesatares evropiane. Grupi aktual i specialistëve të gjinekologjisë dhe obstetrikës është duke u plakur, ndërsa numri i mjekëve të përgjithshëm të familjes është duke shënuar rënie. Numri i mamive gjithashtu po ulet me shpejtësi, veçanërisht ato me arsim sipëror profesional.

Sipas vlerësimeve të fundit⁷⁷, 98.6 për qind e grave shtatzëna marrin kujdes prenatal (para lindjes) dhe 99.9 për qind të lindjeve bëhen nën kujdesin e një personeli të aftë shëndetësor. Sidoqoftë, shkalla e vdekshmërisë perinatale (ca javë para ose pas lindjes) në Maqedoninë së Veriut me 16/1000 në vitin 2016 ka qenë më e larta në mesin e vendeve me standarde të njëjta, ndërsa shkalla e vdekshmërisë së foshnjave dhe të fëmijëve nën moshën 5 vjeçare është më e lartë se mesatarja e Evropës Juglindore (EJL-së) dhe BE-së. Shkalla e lartë e operacioneve cezariane mund të jetë indikacion për pranime dhe kujdes të papërshtatshëm. Kujdesi shëndetësor i nënës dhe fëmijës është i arritshëm për pothuajse të gjithë qytetarët në vend, por ka dallime të konsiderueshme në numrin e mjekëve në dispozicion, qasjen dhe cilësinë e tyre, nëpër rajone, komuna dhe qytete. Kostot e transportit mund të jenë një pengesë e konsiderueshme për qasje sepse të gjithë gjinekologët kryesorë gjenden në zonat urbane.

71 Shih Lucheska I. Mladenovikj B. Reproductive health care in the Republic of Macedonia: situational analysis with a focus on human resources HERA - Health education and research association (2019) Skopje

72 Të dhëna nga World Bank North Macedonia Public Finance Review: Sowing the Seeds of a Sustainable Future op cit.

73 World Bank North Macedonia Public Finance Review: Sowing the Seeds of a Sustainable Future op cit.


74 Të dhënat në këtë paragraph janë marrë nga Finance Think Policy Brief 31 op cit.

75 Milevska Kostova N. WHO (2017) Copenhagen op cit.

76 Finance Think Policy Brief 31 (2018) op cit.

77 World Development Indicators database. Washington, DC: World Bank. (2017) Washington DC <http://databank.worldbank.org/data/reports.aspx?source=world-development-indicators> quoted in North Macedonia Public Finance Review: Sowing the Seeds of a Sustainable Future op cit

Shkalla mesatare e imunizimit të fëmijëve ka rënë nga 94.2 në 90.7 për qind në vitin 2017.



Tani më pak nevoja shëndetësore ngelin të pa-përmbushura për shkak të kostos së lartë të kujdesit, mirëpo nevojat e paplotësuara janë akoma të larta në mesin e amvisërive në kuintilin e të ardhurave të ulëta. Në vitin 2017, më shumë se një e treta e të gjitha shërbimeve shëndetësore janë paguar me participim, duke krijuar mospërputhje sociale në kujdesin shëndetësor⁷⁸. Shpenzimet e paguara me participim në mënyrë të pashmangshme nxisin pagesa edhe/ose joformale, veçanërisht nga pacientë më të varfër, më pak të arsimuar dhe më pak të sigurt për të drejtat e tyre ligjore. Tetëdhjetë e tre për qind e grave shtatzëna në Shuto Orizarë deklaruan se ato nuk e kanë bërë shërbimin e ultrazërit falas, por është dashur të paguanin për të⁷⁹. Për më tepër, kostoja e kujdesit shëndetësor të fëmijëve është rritur⁸⁰ në afro 7,000 denarë në vit në krahasim me 5.860 denarë për të rritur, gjë që sjell një

barrë disproporcionale për familjet me fëmijë, veçanërisht për familjet më të varfra.

Gjendja shëndetësore e popullatës rome është më e keqe se ajo e popullsisë së përgjithshme me jetëgjatësi dukshëm më të shkurtër. Shkaqet e shëndetit të tyre të dobët janë të shumta dhe duhet të adresohen përmes përpjekjeve të përbashkëta të sektorëve shëndetësore dhe jo shëndetësore, përfshirë arsimin, punësimin dhe strehimin. Në vitin 2012 në Maqedoninë e Veriut është krijuar një skemë e suksesshme e ndërmjetësit shëndetësor të romëve, me qëllim të përmirësimit të shëndetit të romëve dhe qasjes së tyre në kujdesin shëndetësor. Në këtë mënyrë synohej të përmirësohet komunikimin midis komunitetit rom dhe sistemit të kujdesit shëndetësor. Kjo duhet plotësisht të integrohet në sistemin nacional të kujdesit shëndetësor.

78 North Macedonia 2019 Report European Commission op cit

79 Health Education and Research Association. Fourth Community Scorecard for Healthcare During Pregnancy, Childbirth and the Postnatal Period among Romani Women in Shuto Orizari, HERA (2016) Skopje available at: <http://hera.org.mk/wp-content/uploads/2016/07/cetvrta-karta-web.pdf>

80 Figures from Finance Think Policy Brief No. 31 (2018) op cit.



(iv) Mbrojtja e fëmijës

Nuk ka të dhëna të mjaftueshme empirike në Maqedoninë e Veriut për shkallën e prevalencës dhe tipologjinë e dhunës që përfshin fëmijët, ndërsa të dhënat bazë për çështjet e mbrojtjes së fëmijëve nuk janë lehtësisht të disponueshme. Kjo mungesë e informacioneve të azhurnuar mund të jetë pjesërisht për shkak të qëndrimeve shoqërore, të cilat në përgjithësi nuk e pranojnë dhunën ndaj fëmijëve si problem, dhe kulturës profesionale, e cila nuk e konsideron si përparësi raportimin e dhunës. Dhuna ende pranohet gjerësisht si një formë e vlefshme dhe efektive e korigjimit dhe ndëshkimit për fëmijët në familje, bashkësi dhe shkolla, madje një studim⁸¹ i kohëve të fundit tregon se profesionistët në të gjithë Maqedoninë e Veriut, janë të ndarë në mendim dhe të paqartë në lidhje me detyrimin e tyre ligjor për të raportuar për të gjitha dyshimet ose shqetësimet në lidhje me dhunën ose abuzimin ndaj fëmijëve.

Në përgjithësi arsimtarët në një studim⁸² mbi dhunën ndaj fëmijëve të realizuar në vitin 2018 kanë vlerësuar se ekziston vetëm një nivel i ulët dhune në shkolla dhe pjesëmarrësit⁸³, përfshirë mjekët, përgjithësisht besonin se dhuna është e rrallë në institucionet e kujdesit për fëmijë në Maqedoninë e Veriut, dhe më së shpeshti ajo shfaqet si dhunë mes bashkëmoshatarëve. Sidoqoftë, Raporti i Departamentit të Shteteve të Bashkuara në vitin 2016⁸⁴ për të drejtat e njeriut në Maqedoni e vuri në pah mungesën e përgjegjësisë për abuzimet në jetimore, strehimore dhe qendra të paraburgimit. Raporti⁸⁵ i vitit 2018 vuri në dukje se vendi kishte akoma ente korrektuese për të mitur, të cilët nuk kishin arritur t'i përmbushin standardet ndërkombëtare dhe se Komiteti për Parandalimin e Torturës KPT (CPT)⁸⁶ në raportin e tij për vitin 2017 vuri në dukje se legjislati akoma lejonte 10 ditë burgim të vetmuar si sanksion disiplinor për të miturit. KPT-ja në vitin 2019 vuri në dukje⁸⁷ se nuk ka pasur përmirësime në kushtet materiale dhe

81 Minton SJ et al Identifying, Assessing and Making Recommendations for State Response Mechanisms in the Prevention, Identification, Reporting, Referral and Protection of Cases of Violence against Children in the Child Protection System in the Former Yugoslav Republic of Macedonia UNICEF (2018) Skopje hereafter VAC 2018

82 Ibid

83 Minton SJ et al (2018) op cit.

84 See https://www.state.gov/2016-17-advancing-freedom-and-democracy-report/#_ednref33

85 Macedonia 2018 Human Rights Report US Department of State (2019) Washington available at <https://mk.usembassy.gov/wp-content/uploads/sites/249/NORTH-MACEDONIA-2018-HUMAN-RIGHTS-REPORT.pdf>

86 Committee for the Prevention of Torture Report to the Government of "the former Yugoslav Republic of Macedonia" on the visit to "the former Yugoslav Republic of Macedonia" carried out by the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT) from 6 to 9 December 2016 Council of Europe (2017) Strasbourg

87 North Macedonia 2019 Report European Commission op cit.

disponueshmërinë e arsimit për fëmijët e ndaluar dhe se urgjentisht duhet të adresohen kushtet e dobëta në stacionet e policisë, institucionet e kujdesit shoqëror dhe institucionet psikiatrike. Në vitin 2018, 55 fëmijë u arrestuan në Qendrën e ndalimit për të huajt, ndërsa 37 prej tyre ishin të pashoqëruar⁸⁸.

Sado që mund të jetë e cunguar kjo dëshmi e shkeljeve të të drejtave të fëmijëve në sistemin e mbrojtjes së fëmijëve; spektri dhe larmia e ambienteve ku fëmijët mund të mbahen të mbyllur nga zyrtarët e shtetit; aspektet e papranueshme të kushteve dhe rrethanave të qëndrimit të tyre; dhe mungesa akute e azhurnuar e hulumtimit dhe analizës kontekstuale, mund të jetë e përshtatshme që të përfshihet një kornizë nacionale⁸⁹ për monitorim dhe raportim të rregullt, të vazhdueshëm dhe të pavarur për të gjithë fëmijët në institucionet shtetërore të çdo lloji në Maqedoninë e Veriut, që është në përputhje me strategjinë aktuale të de-institucionalizimit.

Strategjia nacionale e de-institucionalizimit (2018-2027) synon të mundësojë që asnjë fëmijë nën 18 vjeç të mos mbahet në institucione të kujdesit. Numri i fëmijëve në institucione ka rënë nga 182 në vitin 2017 në 43 në vitin 2019 dhe nga muaji mars i vitit 2019⁹⁰ ka pasur 384 fëmijë në kujdestari. Po ashtu po zhvillohen shërbime shtesë të bazuara në komunitet, gjë që padyshim e zvogëlon rrezikun e dhunës ndaj fëmijëve, mirëpo mundësia për abuzim dhe neglizhencë ekziston në të gjitha format e kujdesit alternative.

Kodi Penal është në përputhje të gjerë me standardet evropiane dhe e kriminalizon trafikimin e qenieve njerëzore dhe pornografinë e fëmijëve në internet. Ligji për familjen dhe ligji për mbrojtjen e fëmijëve ofrojnë masa specifike të mbrojtjes së fëmijëve kundër dhunës, abuzimit dhe neglizhencës. Të dy ligjet caktojnë mandatin parësor për mbrojtjen e fëmijëve në Qendrat lokale për punë sociale (QPS). Ekziston një rrjet me tridhjetë QPS në mbarë vendin dhe shumica prej tyre mbulojnë më shumë se një komunë. Megjithatë komunat kanë përgjegjësi për ofrimin e shërbimeve sociale, QPS-të nuk

janë të decentralizuara, gjegjësisht ngelin nën menaxhimin e drejtpërdrejtë të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale (MPPS). Për ofrimin e një shërbimi tërësor, gjithëpërfshirës dhe me kosto efektive për përkrahjen e familjes nevojiten lidhje të forta zyrtare, statutare dhe të detyrueshme me komunën dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve në nivelin lokal. Në fakt këto lidhje nuk duket se janë krijuar në kuadër të modelit aktual. Iniciativat ndërmjet agjencive në nivelin lokal priren të zhvillohen në mënyrë sporadike sesa si pjesë e një strategjie të planifikuar që mbështet një qasje gjithëpërfshirëse dhe mundëson racionalizimin e vazhdueshëm, zgjerimin dhe zhvillimin e shërbimeve për fëmijë dhe familje, gjegjësisht përdorimin më të mirë të burimeve të kufizuara për përfitimet e klientëve.

Mbrojtja e fëmijëve është vetëm një element i një përgjegjësie më të gjerë për ofrimin e shërbimeve sociale, që përfshin gjithashtu edhe administrimin e sistemit të ndihmës sociale. Procesi i pagesës së mirëqenies sociale tani është modernizuar dhe në vitet e kaluara ka pasur zhvillim të konsiderueshëm të burimeve të kujdesit dhe mbrojtjes mbi bazën e komunitetit. Ka pasur gjithashtu ndryshime në përshkrimet e vendeve të punës dhe praktikave të punës, por sistemi i QPS-ve është akoma i mbingarkuar dhe vullneti i stafit sipas vetë përshkrimit të tyre raportohet të jetë i ulët⁹¹.

Përkundër zhvillimeve të fundit në kujdesin e bazuar në komunitet, studimi⁹² i vitit 2018 i dhunës ndaj fëmijëve tregon se Maqedonia e Veriut ka një nga nivelet më të ulëta të kujdesit për prindërit/kujdestarët në rajon. Gjithashtu studimi vuri në dukje se vendi ka nivelin e dytë më të lartë të fëmijëve që kanë shkelë ligjin në rajon dhe se vazhdon të theksohet ndëshkimi dhe dënimi nën kujdestari, në vend se të theksohet preventiva dhe rehabilitimi. Reforma gjyqësore ka vazhduar për disa vite, mirëpo RPSH për vitin 2019 vëren⁹³ se pjesa më e madhe e shërbimeve të dënimit me kusht janë prolonguar më tej në vitin 2018. Sidoqoftë, pas miratimit të legjisllacionit dytësor përkatës në maj të vitit 2018, gjykatat ngadalë kanë filluar të shqiptojë sanksione alternative të paraburgimit.

88 MYLA (2019) Skopje op cit

89 Defence for Children International (DCI) Belgium has already developed such a framework. See Grabdfils S. et al PRACTICAL GUIDE Monitoring places where children are deprived of liberty DCI Belgium (2016) Brussels


90 Figures received from UNICEF Skopje. Accurate as of 30 June 2019. Number in foster care accurate as of March 2019.

91 Ruda S. Silva A./BIT Applying Behavioural Insights to Teachers' and Social Workers' Motivation UNICEF (2019) Shkup

92 Minton SJ et al (2018) op cit.

93 North Macedonia 2019 Report European Commission op cit.

Maqedonia e Veriut e ka një nga shkallët më të ulëta në rajon të kujdesit nga prindërit kujdestarë/tutorët.



Maqedonia e Veriut u pozicionua në Tier 2 për trafikimin me qenie njerëzore⁹⁴ në 2018 pasi që u gjykua që qeveria nuk i kishte përmbushur plotësisht standardet minimale për eliminimin e trafikimit, megjithatë u pranua që Qeveria po bënte përpjekje të konsiderueshme për t'i arritur ato standarde dhe demonstronte rritje të përpjekjeve në krahasim me periudhën e mëparshme të raportimit. Qeveria identifikoi nëntë viktima duke përfshirë gjashtë viktima të trafikimit seksual në 2018, nga të cilët tre ishin fëmijë. Raporti i Progresit të Shtetit⁹⁵ për vitin 2019 vëren se do të nevojiten strehimore shpesh për viktimat e dhunës seksuale dhe gjinore dhe trafikimin e qenieve njerëzore, me qëllim që të përmbushen standardet e Konventës së Stambollit. Ekzistojnë pabarazi rajonale dhe urbane/rurale midis QPS-ve dhe megjithëse shumica e kushteve të kujdesit shoqëror të QPS-ve përfshijnë punonjës socialë, psikologë, pedagogë dhe

avokatë, jo të gjitha këto role janë në dispozicion në secilën QPS. Burimet dhe objektet nuk janë shpërndarë në mënyrë të barabartë, andaj disa komuna kanë resurse më të mira sesa të tjerat. Gjithashtu studimi i dhunës ndaj fëmijëve i vitit 2018 nënkupton që ka pabarazi rajonale në të kuptuarit e profesionistëve për abuzimin e fëmijëve dhe në angazhimin e tyre për t'i raportuar rastet e tilla, ose për të vepruar ndaj incidenteve të dhunës. Kjo padyshim ndikon në ngarkesën e lëndëve të QPS-ve lokale. Shumica e QPS-ve janë përgjegjëse për të paktën një qendër kujdesi ditor për personat me aftësi të kufizuara, ose për personat më të moshuar, strehimoret për viktimat e dhunës në familje, shtëpitë grupore ose për ndonjë institucion të tillë. Sidoqoftë, hulumtimi⁹⁶ në terren tregon se disa nga qendrat e kujdesit ditor nuk janë të hapura ose nuk punojnë. Familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara në zonat rurale kanë mungesë të shërbimeve, ndërsa transporti

94 Trafficking in Persons Report 2018 US Department of Labor (2019) Washington DC, gjendet në <https://www.state.gov/reports/2019-trafficking-in-persons-report-2/north-macedonia/> përpos nëse nuk henksohet ndryshe, numrat dhe të dhënat në dy paragrafet e mëtejme janë nga Raporti TIP 2019 dhe bazohen në të dhëna zyrtare.

95 North Macedonia 2019 Report European Commission op cit

96 Ibid.

është i disponueshëm vetëm për disa nga qendrat e kujdesit ditor. Disa sosh edhe kujdesen për grupe të përziera të fëmijëve dhe të rriturve në të njëjtën kohë, gjë që ka implikime mbrojtëse, dhe shumë qendra prirën të përqëndrohen në kujdes, në vend se të mbështesin përfshirjen e fëmijëve në kopshte dhe shkolla⁹⁷.

Përderisa hulumtimet⁹⁸ tregojnë se shumë fëmijë në Maqedoni janë në rrezik të abuzimit⁹⁹, përgjithësisht pranohet nga të gjithë palët e interesuara që romët mbesin në rrezikun më të lartë të varfërisë dhe privimit dhe ka më shumë të ngjarë që më shumë se çdo grup tjetër etnik ta vuajnë diskriminimin, përjashtimin shoqëror dhe paragjykimet. Zyra e Avokatit të Popullit¹⁰⁰ raporton për 337 lypës fëmijë të regjistruar në rrugë në 2017, nga të cilët 328 janë Romë të të

gjitha grup-moshave, përfshirë edhe foshnjat. Mbrojtja për fëmijët me aftësi të kufizuara gjithashtu pranohet të jetë e papërshtatshme. Në tetor të vitit 2018 Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara rekomandoi përpjekje të mëtutjeshme për të garantuar mos-diskriminimin, për të shfuqizuar dispozitat që lejojnë privimin e pavullnetshëm të lirisë, për të përmirësuar qasjen, për të siguruar arsim gjithëpërfshirës, etj. Në vitin 2018, zyra e Avokatit të Popullit raportoi¹⁰¹ 21 ankesa në lidhje me diskriminimin ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara. Fëmijët në migrim, fëmijët e mbetur në institucione dhe fëmijët në paraburgim janë gjithashtu veçanërisht të prekshëm ndaj dhunës, abuzimit dhe shfrytëzimit, megjithëse nuk ka të dhëna të mjaftueshme ose dokumentacion për situatën e tyre.

97 Shih po ashtu Mihajlova N. et al Assessment of alternative forms of care and family support services for children with disabilities UNICEF (2016) Skopje op cit.

98 Shih Minton SJ et al (2018) op cit.

99 Shih GFK Skopje Survey on parents' and caregivers' Knowledge, Attitudes, Practices & social norms associated with Violent Forms of Child Discipline UNICEF (2017) Skopje

100 North Macedonia 2019 Report European Commission op cit

101 100 Annual Report, 2018 Ombudsman of the Republic of Macedonia (2019) Skopje op cit.



(v) Mbrojtja sociale

Ndonëse ka statusin e shtetit me të ardhura të mesme, Maqedonia e Veriut është akoma më e varfër se shumica e vendeve të BE-së, dhe gati një e treta e popullsisë së saj konsiderohet e cenushme. Ka pasur përparim të konsiderueshëm në largimin e qytetarëve të Maqedonisë së Veriut nga varfëria gjatë dekadës së fundit, mirëpo HECJ për vitin 2016 theksoi se standardi i jetesës (vlerësuar në 5.2 nga 10) është ende nën mesataren e BE-së (7.0). Ata që marrin më pak përfitime nga rritja e prosperitetit ekonomik përfshijnë familjet rurale dhe ato që jetojnë në rajonet veriore dhe pakicat etnike. Në zonat më të largëta veriperëndimore dhe verilindore, varfëria ishte afër 40 për qind ndërsa shkalla e varfërisë në Shkup dhe rajonin Juglindor mbetet afër nivelit nacional. Varfëria në rajonet e mbetura ka rënë në 10 deri në 14 për qind¹⁰². Edhe pse statistikat zyrtare të mirëqenies sipas grupit etnik nuk janë të disponueshme, gjetjet e HECJ-së¹⁰³ tregojnë se familjet etnike shqiptare përbëjnë më shumë se 40 për qind të kuintilit më të varfër, me vetëm dy të tretat e të ardhura të disponueshme të bashkëmoshatarëve të tyre etnikë maqedonas.

Gjysma e këtij dallimi vazhdon edhe pas kontrollit për karakteristikat tjera socio-demografike. Popullsia rome jo vetëm që është e përqendruar në 40 përqindëshin e poshtëm, por është gjithashtu shumë më poshtë se maqedonasit etnikë në rezultatet e tregut të punës, kapitalin njerëzor dhe treguesit e tjerë jo-monetar të varfërisë. Gjysma e të gjithë qytetarëve në moshë pune nuk kanë punë, madje sipas Bankës Botërore¹⁰⁴, përkatësia etnike në Maqedoninë e Veriut e shpjegon më shumë pabarazinë në mundësinë e punës sesa në cilindo shtet tjetër në rajon.

Siç u theksua më lartë, pothuajse një e treta e fëmijëve në shtet janë në rrezik të varfërisë. Duke pasur parasysh faktin që fëmijët janë më të përfaqësuar në mesin e të varfërve, mbrojtja sociale luan rol të rëndësishëm, pasi që ajo mund t'i zbus efektet e privimit, të cilin e përjetojnë fëmijët.

Hartimi dhe administrimi i masave të mbrojtjes sociale është përgjegjësia kryesore e Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale. Në Maqedoninë e Veriut, mbrojtja sociale sigurohet përmes një kombinimi të programeve të përfitimeve në para dhe shërbimeve

¹⁰² Ibid

¹⁰³ Sondazhi i Cilësisë së Jetës në Maqedoni u mbledh në maj-qershor 2017. Ai u hartua nga grupi i ekspertëve të Financial Think dhe përfshinte si individë ashtu edhe familjet. Ajo mbledhi të dhëna për demografinë, kushtet socio-ekonomike, konsumin, të ardhurat dhe treguesit e tregut të punës, midis fushave të tjera. Shih <http://www.financethink.mk/models/survey-on-quality-of-life-in-macedonia-2017/> Citohet në Seizing a Brighter Future for All Former Yugoslav Republic of Macedonia Systematic Country Diagnostic World Bank Group (2018) Washington

¹⁰⁴ Seizing a Brighter Future for All Former Yugoslav Republic of Macedonia Systematic Country Diagnostic World Bank (2018) op cit.


të përkrahjes dhe kujdesit sociale. Masat e mbrojtjes sociale për fëmijët bëjnë pjesë në katër programe, të zbatuara dhe të mbikëqyrura nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale: mbrojtja e fëmijëve; përfitimet dhe asistencat sociale; kujdesi institucional; dhe mbrojtje jashtë institucionale¹⁰⁵. Këto masa janë përcaktuar për ta përmirësuar standardin dhe cilësinë e jetës së fëmijëve, duke krijuar në të njëjtën kohë kushte për kujdes dhe mbrojtje të fëmijëve që vijnë nga familjet e cenueshme dhe familjet në rrezik social. Për shembull programi për mbrojtjen e fëmijëve përfshin katër elemente të ndërlidhura mes vete: mbrojtja ligjore e të drejtave të fëmijëve dhe mbështetja profesionale për familjet në nevojë; qasja në shërbimet e mbështetjes mbi bazë të komunitetit; kujdesi dhe edukimi i fëmijëve parashkollorë; dhe opsionet alternative të kujdesit institucional dhe mbi bazë të komunitetit.

Buxheti i përgjithshëm i Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale përbëhet nga disa komponentë: (i) Mbrojtja Sociale (përfshin ndihmën sociale siç janë pensionet dhe pagesat për aftësisë të kufizuar, si dhe pagat e stafit për QPS-të etj.); (ii) Mbrojtja e fëmijëve (përfshin kryesisht shpenzime që lidhen me kopshtet për fëmijë dhe mësimin e hershëm parashkollor); (iii) Puna (përfshin shpenzimet që

lidhen me programet e tregut të punës, standardet për sigurinë e punës, të drejtat e punës, etj.); dhe (iv) Shërbime tjera (migrantët, urgjencat, etj.). Sigurimi i përfitimeve sociale, asistencës dhe shërbimeve sociale është mandati i rjetit të Qendrave për Punë Sociale dhe institucioneve të mirëqenies sociale, gjë që është rregulluar me ligjin e mbrojtjes sociale, ligjin për mbrojtjen e fëmijëve, ligjin për familje dhe aktet nënligjore të ndërlidhura me to. Dokumentet strategjike si Strategjia nacionale për zbutjen e varfërisë dhe përjashtimit social për vitet 2010-2020 dhe Programin nacional për zhvillimin e mbrojtjes sociale 2011–21 përcaktojnë objektivat e mbrojtjes sociale dhe specifikojnë se çfarë duhet të bëhet për t'i përmbushur ato.

Rreth 14 për qind të totalit të shpenzimeve të BPV-së¹⁰⁶ në Maqedoninë e Veriut shkojnë për mbrojtjen sociale, përfshirë sigurimet sociale, ndihmën sociale dhe programet e tregut të punës, që duket se është e lartë në krahasim me vendet me standarde të ngjashëm, por në 10.5 për qind të PBB-së në vitin 2017, shpenzimet për pensione përbëjnë pjesën më të madhe të shpenzimeve për mbrojtje sociale. Megjithatë shpenzimet e përgjithshme për mbrojtje sociale janë pothuajse dyfishi i shpenzimeve totale për arsim, vetëm 25 për qind e tyre iu dedikohen fëmijëve¹⁰⁷. Në të kundërt, shpenzimet e Maqedonisë

Pothuajse një e treta e fëmijëve në shtet janë në rrezik të varfërisë.



105 Për analizë më të plotë shihni Bogoevska N. World Bank (2017) Skopje op cit. and Finance Think Policy Brief No.30 How much does the state allocate for education and social protection of children? UNICEF (2018) Skopje

106 Përpos nëse theksohet më ndryshe, të dhëna në këtë paragraf janë marrë nga Raporti i Bankës Botërore për Maqedoninë e Veriut: Sowing the Seeds of a Sustainable Future op cit.

107 Finance Think Policy Brief No.30 (2018) op cit.

së Veriut për ndihmë sociale, në nivelin 1.2 për qind të BPV-së në vit për vitet 2014-17, janë shumë më poshtë nga mesatarja (2.2 për qind) për rajonin e Evropës Lindore dhe Azisë Qendrore.

Në maj të vitit 2019, vendi miratoi një ligj të ri për mbrojtjen sociale. Ligji i ri ruan jokushtëzimin, krijon të drejta të mëtejshme financiare dhe i integron ato me shërbimet e ofruara sociale. Ene nuk ka ende hulumtim të mjaftueshëm mbi ndikimin e pakos së përfitimeve dhe masave administrative mbi varfërinë familjare, por ai i ka lehtësuar përfitimet për personat me aftësi të kufizuara, përfshirë fëmijët dhe familjet. Njëri ndër ndryshimet më të rëndësishme të sjella nga ligji i ri është sistemimi i asistencave të ndryshme për aftësi të kufizuara dhe krijimi i një pagesës së vetme për aftësisë të kufizuara, që gjithashtu përfshin personat me aftësi të kufizuara intelektuale të moderuar dhe të rëndë. Po aq të rëndësishme janë ndryshimet legjislative në lidhje me shërbimet sociale për njerëzit me aftësi të kufizuara p.sh. ndihmë personale, ndihmë në shtëpi dhe shërbime të kujdesit.

Shumica e masave brenda sistemit të mbrojtjes sociale synojnë t'i mbështesin prindërit në përkushtimin e tyre në rritjen e fëmijëve të tyre dhe të përfshijnë transferime financiare për prindin ose kujdestarin e fëmijës në kuadër të komunitetit. Sidoqoftë, eksitojnë edhe masa specifike në buxhetin e mbrojtjes sociale, të cilat synojnë të sigurojnë kujdesin dhe zhvillimin e fëmijëve pa përkujdesje të duhur prindërore, ose prindërit e të cilëve e kanë humbur të drejtën ose kanë hequr dorë nga e drejta e tyre për kujdestari. Këto masa synojnë të sigurojnë mbrojtje dhe kujdes për fëmijët që kanë nevojë për kujdes, mbikëqyrje dhe ndihmë, gjegjësisht për fëmijët të cilëve iu mungojnë kushtet e përshtatshme për rritje dhe zhvillim brenda familjeve të tyre.

Struktura e sistemit të ndihmës sociale të Maqedonisë së Veriut është e pabarabartë, me një pjesë të konsiderueshme të mjeteve që shkon në programe jo të testuar për adekuatshmërinë e dhënies së mjeteve, dhe me në rënien e asistencës për familjet më të varfra. Shpenzimet e përgjithshme për programet e testuar për adekautshmërinë e dhënies së mjeteve kanë rënë nga 0.82 për qind të BPV-së në 2008 në 0.6 për qind në vitin 2017, ndërsa shpenzimet për programe jo të testuar për

adekuatshmërinë e dhënies janë më shumë së dyfishi i tyre. Është e paqartë nëse ky trend do të vazhdojë edhe në masat e reja. Shkalla e lartë e varfërisë së Maqedonisë së Veriut dhe mundësitë e kufizuara të punësimit, duket se kundërshtojnë këtë model të financimit të mbrojtjes sociale. Varfëria dhe pabarazia janë ende të larta në krahasim me shtetet tjera të rajonit me standard të ngjashëm¹⁰⁸. Edhe pse shkalla e varfërisë relative¹⁰⁹ e Maqedonisë së Veriut ishte 22 për qind në 2016 vetëm rreth pesë për qind e qytetarëve të Maqedonisë së Veriut jetojnë në familje ku të paktën një anëtar merr ndihmë të synuar sociale ose asistencën përkatëse. Përderisa shtrirja e ndihmës sociale për kuintilin më të ulët është zgjeruar në mënyrë të konsiderueshme nga 27.2 në 33.9 për qind midis 2010 dhe 2016, në përgjithësi Maqedonia e Veriut nuk qëndron mirë në raport me shtetet tjera të rajonit me standard të ngjashëm. Vendet tjera, të cilat kanë shërbime të ngjashme të shpenzimeve të ndihmës sociale, ose edhe janë shumë më të ulëta, kanë nivele shumë më të mira të shtrirjes dhe përcaktimit të kuintilit më të varfër p.sh. 80 për qind në Letoni dhe 90 për qind në Rumani.

Maksimizimi i kostos dhe efektivitetit të mbrojtjes sociale për fëmijët dhe familjet do të kërkonte një rritje të konsiderueshme të mbulimit të familjeve në kuintilet e ulëta, dhe një ri-drejtim masiv të fondeve ndaj familjeve dhe fëmijëve në përgjithësi, gjegjësisht fëmijëve më të varfër dhe familjeve në veçanti. Shpenzimet e mbrojtjes sociale, si një pjesë e BPV-së, u rritën me 30 për qind që nga viti 2010, dhe llogariten 20 për qind të shpenzimeve të përgjithshme në vitin 2018. Elementi i mbrojtjes së fëmijëve në kuadër të buxhetit do të ishte rritur më shumë se tre herë, krahasuar me 39 për qind e rritjes së pagave. Mirëpo kjo me siguri ka ngjarë për shkak të futjes së asistencës së prindërve për fëmijë të tretë dhe të katërt, e cila filloi në vitin 2009, dhe kostot e së cilës janë rritur në mënyrë rapide çdo vit në vijim. Programet e tjera të cilat i kanë synuara fëmijë dhe familjet e varfra dhe të cenueshme, zënë vetëm 3.9 për qind të fondeve të përgjithshme të mbrojtjes sociale të alokuara në vitin 2018. Kjo përfshin fondet e ndara për institucionet e mbrojtjes së fëmijëve; ndërtimi, pajimi dhe mirëmbajtja e enteve për mbrojtjen e fëmijëve, qendrave të kujdesit ditor dhe strehimoreve për mbrojtje sociale jashtë institucionale dhe transferimeve të me kusht.

108 Poverty Reduction, Shared Prosperity, and Inequality in North Macedonia in the Post-Crisis Period (2009-2013) World Bank (2016) Washington

109 Shkalla e varfërisë është vendosur në përqindjen e 20-të të shpërndarjes së popullsisë, gjë që bën të mundur krahasimin e rezultateve me kalimin e kohës dhe në të gjithë vendet. Ajo matet si pjesa e popullsisë që jeton nën 60 për qind të familjes mesatare për të ardhura ekuivalente të të rriturve.



i. Shtytësit e pabarazive

(i) Mungesa e kulturës së të drejtave të njeriut

Megjithëse Maqedonia e Veriut në çdo sektor ka miratuar legjislacion, politika dhe strategji në përputhje me normat dhe standardet ndërkombëtare, përparimi drejt arritjes së këtyre standardeve është i ngadaltë. Në përgjithësi, shoqëria ende nuk ka zhvilluar një kulturë për të drejtat e njeriut dhe normat e të drejtave të fëmijëve nuk janë përfshirë në sjelljen shoqërore ose planifikimin e shërbimit. Vendit i mungon një strategji e pajtuar kombëtare për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, ndërsa organ ligjor i ngarkuar me mbikëqyrjen e realizimit të Konventës duket se është i dobët. Shoqëria civile është akoma mjaft e dobët dhe nuk ka asnjë lobi të fortë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në mesin e OJQ-ve, botës akademike ose mediave. Mbetet shumë punë për ta forcuar dhe zgjeruar elektoratin e mbështetjes për të drejtat e fëmijëve në Maqedoninë e Veriut.

(ii) Segregacion, përjashtimi social dhe pabarazia


Edhe pse madhësia e vogël e vendit dhe popullsisë të jep përshtypjen e kohezionit shoqëror, Maqedonia

e Veriut është një shoqëri mjaft e veçuar dhe e shtresuar, koeficienti i saj Gini tregon një nivel të lartë të pabarazisë. Ndonëse institucionet sociale me vetëdije po kërkojnë ta korrigjojnë këtë, prapëseprapë ka prirje që komuniteti të përcaktohet për nga përkatësia etnike, normat shoqërore, mirëpo modelet e më shumë forcojnë ndarjen etnike sesa përfshirjen sociale. Ndërveprimi midis qytetarëve shqipfolës dhe folësve të maqedonishtes rritet në raport me iniciativat qeveritare, mirëpo norma bazë ngel ndarja etnike në shkolla dhe komunitete. Është e rëndësishme që diferencimet etnike dhe pabarazitë të identifikohen dhe adresohen në mënyrë të qartë në lidhje me fëmijët, në mënyrë që të sigurohen mbyllja e boshllëqeve në raport me barazinë, si dhe plotësisht të respektohet fryma dhe narracioni i nenit 2 të Konventës në Maqedoninë e Veriut. Ekziston gjithashtu një diferencë e fortë urbane/rurale, dhe boshllëqe socio-ekonomike të konsiderueshme dhe zgjeruese midis rajoneve, veçanërisht midis Shkupit dhe pjesës tjetër të vendit. HECJ¹¹⁰ nga viti 2016 konfirmoi nivele të larta të stigmës dhe përjashtimit shoqëror të të varfërve.

Pabarazia gjinore ende pengon në mënyrë të konsiderueshme përparimin drejt një kulture të të drejtave të njeriut në Maqedoninë e Veriut. Rolet, përgjegjësitë dhe autoritetet e grave në familje, bashkësi dhe shoqëri janë dukshëm në varësi të burrave, kështu që, gratë dhe vajzat kanë një pjesë

110 Eurofound (2019) op cit.

Vetëm 26 për qind të kompanive kanë menaxhere gra.



më të madhe të barrës së varfërisë dhe përfitojnë më ngadalë nga rritja e prosperitetit. Stereotipizimi gjinor është gjithashtu një shkaktues i rëndësishëm i dhunës në familje dhe dhunës gjinore. Duhet të bëhet një investim i rëndësishëm në barazinë gjinore dhe institucionet e mundshme të barabarta duhet të forcohen në mënyrë të konsiderueshme, nëse Maqedonia e Veriut do të përfitojë ashtu siç duhet nga pjesëmarrja e plotë, aktive dhe e barabartë e grave në zhvillimin e vendit. Ndryshimi i qëndrimeve të djemve dhe vajzave ndaj stereotipit gjinor dhe çekuilibrit gjinor duhet të jetë një element thelbësor i çdo strategjie të zhvillimit.

(iii) Legjislacioni, politika dhe buxheti

Në përgjithësi, kornizat e nevojshme legjislative dhe të politikave janë krijuar për të lehtësuar aksesin e fëmijëve në të drejtat e tyre, megjithëse jo të gjithë janë në përputhje të plotë me parimet dhe dispozitat e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve¹¹¹. Përderisa reforma legjislative është ende e nevojshme në shumë fusha, Vëzhgimet përfundimtare¹¹² të Komitetit për të Drejta e Fëmijëve KDF (CRC) i japin përparësi zbatimit të legjislacionit ekzistues mbi reformën.

Buxheti i pamjaftueshëm është një pengesë e rëndësishme në implementim. Megjithëse

Maqedonia e Veriut tani ka arritur statusin e vendit me të ardhura të mesme, ajo akoma ndan më pak mjete proporcionale buxhetore për sektorët e fëmijëve sesa vendet ekuivalente në rajonin e Evropës Lindore dhe Azisë Qendrore. Shfrytëzimi i pamjaftueshëm i fondeve të disponueshme paraqet një shqetësi tjetër, i cili nuk mund plotësisht të verifikohet në mungesë të të dhënave të mira cilësore për grupet vulnerable, siç janë fëmijët me paaftësi të komunitetit rom. Në Maqedoninë e Veriut nevojitet urgjentisht një analizë e plotë me fokus te fëmijët në kuadër të proceseve të buxhetimit, ndarjes së fondeve dhe shpenzimeve, e cila e ekzaminon efikasitetin e kostos së modeleve aktuale të shpenzimeve midis shërbimeve që kanë të bëjnë me fëmijët. Sidoqoftë edhe të dhënat ekzistuese demostrojnë se në disa raste fondet e qeverisë subvencionojnë përfitues më të mëdhenj, në vend se t'i mbështesin familjet me nevoja të mëdha.

(iv) Personeli, profesionistët dhe praktikuesit

Perceptimi i publikut se emërimet publike, shpërndarja e burimeve dhe zhvillimi i programeve mund të ndikohen nga proceset politike, paraqet një veprim për t'i heshtur ankesat për shërbimet e këqija ose praktikatat diskriminuese. Ligji për të

111 Shih Davitkovski B. et al Comparative Review of Legislation in the Republic of Macedonia and the Convention on the Rights of the Child, Ministry of Justice Republic of Macedonia, Skopje, May 2010

112 Concluding Observations: former Yugoslav Republic of Macedonia CRC (June 2010) Geneva

punësuarit në sektorin publik përcakton rekrutimin në bazë të meritës, por ai ende nuk është aplikuar plotësisht dhe akoma nuk është i vendosur një sistem efektiv dhe gjithëpërfshirës i menaxhimit të suksesit të punës. Faktorët tjerë, që pengojnë formulimin e politikave dhe ofrimin e shërbimeve, përfshijnë fuqinë punëtore në plakje e sipër, vullnetin e dobët të stafit, zinxhirët e menaxhimit hierarkikë dhe të centralizuar, që nuk i fuqizojnë menaxherët dhe profesionistët lokal.

Faktor tjetër i rëndësishëm që ndikon negativisht në realizimin e të drejtave të fëmijëve është rënia e cilësisë së arsimit profesional në fushat kryesore, që kanë të bëjnë me fëmijët, pas hapjes së tregut të universitetit në Maqedoninë e Veriut. Maqedonia e Veriut shpenzon më pak për arsimin terciar sesa vendet tjera me standarde të ngjashme dhe kjo në mënyrë të pashmangshme ndikon negativisht në kualifikimin profesional të arritur nga personat e diplomuar. Kjo çështje duhet të trajtohet urgjentisht përpara se t'u vijë radha të ofrojnë shërbime personat me cilësi të dobët të arsimit dhe të pensionohet stafi me përvojë.

Mund të zgjasë ca kohë përpara se iniciativat qeveritare për përmirësim të përfaqësimit etnik të shërbimeve publike të prodhojnë një grup të mjaftueshëm të personelit të shkathët, të kualifikuar dhe me përvojë të aftë për t'i shërbyer siç duhet komuniteteve etnike të pakicave. Me rëndësi është që të vendosni marrëveshje të përkohshme që ofrojnë shërbim të duhur dhe i adreson pabarazitë themelore midis grupeve etnike.

(v) Sistemi, strukturat dhe ofrimi i shërbimeve

Pengesa të rëndësishme rreth qasjes së fëmijëve në të drejtat e tyre ndodhin në pikëtakimin midis kornizave legjislativë, politikave dhe strategjive të përcaktuara në nivel qendror, dhe mekanizmave lokalë të ofrimit të shërbimit dhe sistemeve të menaxhimit. Delegimi i përgjegjësisë, resurseve dhe autoritetit për zhvillimin e shërbimeve të komunave është një element kryesor i modelit të zhvillimit të qeverisë, një program¹¹³ i tillë për zbatimin e decentralizimit ka filluar që nga viti 2011. Megjithatë ofrimi i shërbimeve mbetet i fragmentuar në nivelin lokal, andaj modelet e ndryshme sektoriale të decentralizimit duket se vlejnjë në lidhje me shërbimet e fëmijëve, duke

penguar zhvillimin e një qasje gjithëpërfshirëse, të bazuar në të drejta për plotësimin e nevojave të fëmijëve.

Kritika në nivelin qendror ka tendencë ta theksojë patronazhin politik dhe ngurrimin e komunave për të mbledhur të ardhura ose për ta racionalizuar ofrimin e shërbimeve, por ka edhe probleme reale me formulat e shpërndarjes së buxhetit dhe mekanizmat e përzgjedhjes se cilat komuna do t'i marrin fondet përkatëse. Sistemi aktual për transferimin e fondeve nga niveli qendror në atë lokal nuk i adreson pabarazitë sociale dhe ekonomike midis komunave të përcaktuara për nga vendndodhja, madhësia e popullsisë, nevojat e shpenzimeve, bazat e ndryshme ekonomike dhe aftësia për të gjeneruar të ardhura. Shumë komuna si rezultat i mungesës së fondeve nuk janë në gjendje t'i financojnë disa nga funksionet e tyre themelore, me çka shërbimet kyçe si arsimi ngelin të pa financuara sa duhet. Të ardhurat nga taksat lokale përfaqësojnë vetëm një të tretën e të ardhurave të komunave, ndërsa bilanci duhet të përmbushet me transferime nga qeveria qendrore. Bllok donacionet arrijnë rreth 80 për qind të këtyre transferimeve dhe rreth gjysmën e të ardhurave totale të komunave, mirëpo vlera e tyre si përqindje e BPV-së ka rënë, ndërsa niveli i financimit që ata ofrojnë është i papërshtatshëm.

Tatimet lokale nuk kanë qenë në gjendje ta ruajnë hapin me përcaktimin e përgjegjësisë për shpenzimet në nivelin lokal, veçanërisht në komunat rurale me baza të vogla tatimore. Aksioni për t'i zvogëluar këto boshllëqe do të duhet të përfshijë ndërtimin e kapaciteteve për mbledhjen, qasjen, thithjen dhe përdorimin e fondeve, si dhe krijimin e mekanizmave për bashkëpunim ndër-sektorial dhe ndër-komunal, me qëllim që t'i shkëmbejnë dhe konsolidojnë shërbimet e fëmijëve. Për momentin nuk ka asnjë mekanizëm ose format të dakorduar, i cili i lejon njësitë e qeverisjes vendore t'i planifikojnë shërbimet e fëmijëve në mënyrë holistike ose madje strategjike në një mënyrë që do ta lehtësojë sigurimin e koordinuar të mjeteve dhe me kosto efektive për familjet në komunitetet lokale. Mund t'ia vlejnjë të diskutohet zhvillimi i një formati të planifikimit të buxhetimit dhe planifikimit miqësor ndaj fëmijëve me Bashkësinë e njësisive të vetëqeverisjes lokale të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

113 Programet për implementim të procesit të decentralizimit dhe zhvillimit të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2011-2014, Ministria e Vetëqeverisjes Lokale (2011) Shkup

(vi) Grupet prioritare

Duhet të rishikohet dhe riaftësohet e gjithë korniza për realizimin e të drejtave të fëmijëve në Maqedoninë e Veriut, me qëllim që të sigurohet që të gjithë fëmijëve t'iu jepet mundësia që të zhvillohen me potencialin e tyre të plotë dhe ta përrjetojnë dashurinë, prehjen dhe mbështetjen, që shërben si motivim për ta. Sidoqoftë, disa grupe brenda popullatës së fëmijëve kërkojnë veprim intensiv, të përqendruar dhe urgjent për ta zbutur varfërinë, përjashtimin dhe diskriminimin e qartë, që ata po e pësojnë.

Fëmijët romë duhet të kenë prioritet¹¹⁴. Tetëdhjetë e shtatë për qind e fëmijëve romë të lindur në Maqedoninë e Veriut do të përballen me një privim të rëndë material në krahasim me 55 për qind të fëmijëve jo romë që jetojnë në të njëjtën afërsi. Kryefamiljari në amvisërinë e tyre ka tre herë më shumë të ngjarë të jetë i papunë dhe ata kanë dy herë më shumë të ngjarë të jetojnë në një shtëpi të mbipopulluar, ku iu mungon uji i pijshëm, energjia elektrike, ngrohja ose hapësirat sanitare. Një fëmijë rom ka gjithashtu më shumë të ngjarë se një fëmijë jo rom të mos ketë marrë një seri të plotë të vaksinimeve. Si rezultat i kësaj fëmijët romë kanë shkallë më të lartë të morbiditetit dhe mortalitetit sesa popullata e përgjithshme. Një fëmijë rom ka vetëm 1 në 7 shanse të ndjekë edukimin parashkollor në krahasim me një 1 në 3 për fqinjët e tyre jo rom. Po ashtu një në dhjetë fëmijë rom do të braktisë shkollën. Dy nga pesë do të marrin një arsim me cilësi më të dobët në një shkollë të veçuar. Vetëm një në tre do ta përfundojë shkollën e mesme dhe vetëm tre në çdo njëqind do

ta përfundojë shkollimin universitar - më pak se një e dhjeta e përqindjes së të diplomuarve jo romë. Tre të katërtat e të rinjve romë janë të papunë ose nuk janë të përfshirë në trajnime në krahasim me më pak se një e treta e të rinjve jo romë. Në këtë mënyrë veç vazhdon cikli gjenerues i varfërisë. Përmbushja e detyrimeve ligjore të shtetit ndaj fëmijëve romë kërkon krijimin e programeve të masave speciale në të gjithë sektorët, të zhvilluara në bashkëpunim me familjet dhe komunitetet romë.

Fëmijët e tjerë që kanë nevojë për programe speciale për mbrojtje dhe mbështetje përfshijnë fëmijët me aftësi të kufizuara, veçanërisht ata që mbeten në institucione. Rreziku i abuzimit dhe shfrytëzimit të këtyre fëmijëve mbetet i lartë, së bashku me fëmijët në burgje, qendrat korrektuese, qendrat e pritjes, spitalet psikiatrike dhe institucionet e tjera, madje ky rrezik zakonisht përkeqësohet nga izolimi social dhe zvogëlimi i vizibilitetit. Sa më shpejt që të jetë e mundur duhet të vendoset një kornizë e fortë monitorimi, si dhe të mundësohet qasja në mekanizma të pavarur të ankesave. Fëmijët në migracion dhe ata që janë kthyer si azilkërkues të refuzuar janë gjithashtu në veçanti të ndjeshëm ndaj abuzimit dhe eksploatimit, andaj shërbimet ekzistuese nuk duket se janë të përshtatshme për nevojat e tyre. Fëmijët dhe të rinjtë që identifikohen si LGBTI gjithashtu duket se janë në rrezik të lartë dhune dhe abuzimi, mirëpo nuk është realizuar ndonjë hulumtim i mjaftueshëm për ta përcaktuar masën ose natyrën e rrezikut ndaj tyre. Baza aktuale statistikore mund të ketë nevojë të ndryshohet për ta mundësuar planifikimin e duhur dhe adekuat të shërbimit për të gjitha këto grupe.



j. Palët përkatëse

(i) Qeveria

Qeveria vepron si një garantues kryesor i të drejtave të fëmijëve dhe është ndoshta ofruesi më i madh i shërbimeve për fëmijët në Maqedoninë e Veriut. Forcimi i të tri shtyllave të pushtetit (parlamenti, gjyqësori dhe pushteti ekzekutiv) ka qenë një element i qëndrueshëm i programit të reformës gjatë dekadës së kaluar. Përkundër përmirësimit të konsiderueshëm në të tre shtyllat e qeverisjes, prapëseprapë Maqedonia e Veriut ka shënuar mesataren më të ulët të besimit në institucionet shtetërore nga të gjitha vendeve kandidate sipas HCJE 2016¹¹⁵. Në veçanti besimi në autoritetet lokale (3.7) ishte më i ulët në krahasim me të gjitha vendet e tjera.

Tani në institucionet shtetërore ekzistojnë kode etike si dhe janë ndërmarrë hapa për ta përmirësuar transparencën e punës. E drejta e qytetarëve për qasje në informacione publike është përmirësuar përmes publikimit të grupeve standarde të dokumenteve, dhe krijimit të një mekanizmi të hapur të të dhënave. Po ashtu është arritur përparim edhe në përmirësimin e transparencës buxhetore dhe atë të konsultimeve publike, mirëpo edhe pse zyrtarisht informacionet

mbi shërbimet dhe të drejtat janë të qasshme për publikun, ato nuk prezantohen gjithmonë në mënyrë konsistente ose koherente. Qeveria gjithashtu ka bërë përpjekje të konsiderueshme për ta ndalë korrupsionin, mirëpo respektimi i parimeve të transparencës, meritës dhe përfaqësimit të drejtë akoma nuk është mishëruar në shërbimin publik, andaj edhe vazhdon perceptimi i korrupsionit brenda agjencive qeveritare. Kjo veçanërisht haset në lidhje me punësimin dhe praktikën e personelit. Sipas studimit¹¹⁶ për Vlerësimin ndër-sektorial të të rinjve (CSYA), të rinjtë të cilët kanë aspiruar për punësim në sektorin qeveritar kanë pranuar hapur se qasja nuk bazohet gjithmonë në kualifikime. Të rinjtë me të drejtë shprehin pakënaqësi për faktin se nëpunësit publikë marrin rroga, por nuk shkojnë në punë, ndërsa ata nuk mund të gjejnë punë.

Përgjegjësia menaxheriale ende duhet të ndërtohet plotësisht në kulturën organizative të sektorit publik. Aktualisht menaxhimi është i centralizuar me pak delegim të vendimmarrjes ose autoriteteve buxhetore të niveli i mesëm i menaxhimit. Kjo mund të shpijë në vonesa të gjata pasi marrja e vendimeve referohet në mënyrë jo të duhur në zinxhirin e menaxhimit dhe/ose menaxherët i prolongojnë vendimet e tyre, duke pritur ndryshimeve të mundshme të ministrave. Më tej përgjegjësia menaxheriale më shumë

115 Eurofound 2019 op cit

116 Zivetz L./ Navanti (2019) op cit

kufizohet me parimin e pajtueshmërisë, sesa vetë performancës (punës efektive). Vullneti i dobët i stafit është një faktor tjetër që pengon efektivitetin, efikasitetin dhe përgjegjshmërinë brenda shërbimit publik, si edhe është pengesë kryesore për realizimin e plotë të të drejtave të fëmijëve. Zhvillimi profesional akoma nuk është sistematik dhe nuk ka një bazë të centralizuar të të dhënave, lidhur me mundësitë e trajnimit. Cilësia e arsimit profesional në sferat që kanë të bëjnë me fëmijët ka rënë që nga hapja e tregut universitar, dhe si rezultat i kësaj profilet e personave, që aplikojnë për punë për mësimdhënie, kujdes social dhe shëndetësi janë më të dobët se më parë. Universitetet publike u mungon infrastruktura dhe burimet e nevojshme për përmirësim të cilësisë së lëndëve, gjë që ndikon negativisht në cilësinë e shkollës profesionale ose kualifikimin e marrë nga të diplomuarit.

Është krijuar korniza ligjore dhe strukturat institucionale për mbështetje të hartimit të politikave, mirëpo edhe më tej duhet të forcohet planifikimi i politikave, dhe veçanërisht duhet të harmonizohen me planifikimin buxhetor. Politika e bazuar në prova dhe zhvillimi legjislativ sigurohen vetëm pjesërisht dhe duhet të forcohet mbledhja dhe përdorimi i të dhënave për vendimmarrje. Po ashtu është iniciuar një rishikim funksional për t'i vlerësuar institucionet qeveritare, gjë që mund të ofrojë një mundësi të mirë për t'i përfshirë konceptet me fokus të fëmijët, konceptet të favorshme për familjen dhe konceptet e ofrimit të shërbimeve të bazuara në të drejtat, në kuadër të strukturës së shërbimit publik, sistemeve dhe institucioneve të Maqedonisë së Veriut.

Decentralizimi është element kryesor i modelit të zhvillimit të qeverisë, mirëpo një rishikim¹¹⁷ i sistemit të financave publike të Bankës Botërore zbuloi se komunat e kanë vështirë të ofrojnë shërbime publike, për shkak të autonomisë shumë të vogël të ardhurave, funksioneve të ndara dhe të përcaktuara në mënyrë të paqartë, detyrat e paqarta të shpenzimeve dhe kapacitetet institucionale të pabarabarta. Gjithashtu, modele sektoriale të ndryshëm të decentralizimit duket se zbatohen për sa i përket shërbimeve të fëmijëve, pasi që kjo pengon një qasje të integruar holistike në përmbushjen e nevojave të fëmijëve. Fuqia punëtore në plakje, kapaciteti i dobët i personelit, vullneti i dobët dhe qarkullimi i lartë i

stafit të gjithë kontribuojnë në cilësinë e dobët të shërbimeve në kontekst të ofrimit të tyre, mirëpo planifikimi dhe përgatitja e shërbimit pengohet nga mangësitë serioze të mekanizmave aktuale për transferimin e fondeve ndërmjet departamenteve e pushtetit qendror dhe komunave. Sistemi aktual i transferimeve nuk merr parasysh pabarazitë shumë reale sociale dhe ekonomike midis komunave. Veçanërisht të pafavorshme janë komunat rurale dhe ato të vogla me baza të vogla të taksave lokale. Kërkohen metoda të thjeshta dhe transparente për t'i llogaritur nevojat e shpenzimeve që lidhen me përgjegjësitë funksionale si arsimi ose më gjerësisht me grupe specifike të popullsisë siç janë fëmijët. Në të vërtetë, buxheti i fëmijëve është i nevojshëm për secilën ndërtesë të bashkisë për një vlerësim tërësor të nevojave të fëmijëve në secilën zonë të qeverisjes vendore.

(ii) Shoqëria civile

Shoqëria civile në Maqedoninë e Veriut është ende në fazë të hershme të zhvillimit dhe marrëdhënia midis shoqërisë civile dhe bartësve të tjerë të detyrave është ende duke evoluar. Shoqëria është mjaft e politizuar dhe njerëzit zakonisht merren me politikanë, në vend që të ndërmarrin veprime kolektive, për t'i zgjidhur problemet sociale dhe çështjet e komunitetit. Pra angazhimi qytetar nuk është një traditë në Maqedoninë e Veriut. Iniciativat ose rrjetet e kontakteve sociale ose profesionale janë mjaft të kufizuara dhe pak njerëz janë të përfshirë në kategorinë e organizatave qytetare, profesionale ose sindikale, të cilat ndihmojnë në krijimin dhe mbajtjen e kohezionit social në shoqëri. Konstatimet e Vlerësimit ndër-sektorial të të rinjve¹¹⁸ tregojnë se ky model vazhdon tek të rinjtë. Vetëm një pakicë e të rinjve të anketuar kanë marrë pjesë në aktivitete vullnetare ose qytetare, që kontribuojnë në shoqëri. Rinia e marginalizuar është edhe më pak e angazhuar sesa mesatarja kombëtare. Të anketuarit prirën t'i atribuojnë nivele të ulëta të angazhimit qytetar në një histori të përjashtimit nga ligjërimi dhe vendimmarrjes në sferën publike.

Klima në të cilën veprojnë organizatat e shoqërisë civile është përmirësuar disi në kuadër të qeverisë aktuale. Janë miratuar dokumentet strategjike, duke siguruar udhëzime për bashkëpunimin midis qeverisë dhe shoqërisë civile dhe është bërë përparim drejt funksionimit të rregullt të Këshillit për bashkëpunim ndërmjet qeverisë dhe shoqërisë civile. Përpykjet

117 World Bank North Macedonia Public Finance Review: Sowing the Seeds of a Sustainable Future op cit.

118 Zivetz L./ Navanti Group (2019) op cit.

të mëtejshme janë të nevojshme për ta adresuar qëndrueshmërinë e organizatave të shoqërisë civile, siç është një harmonizim më i gjerë i tatimeve dhe buxhetimi i parashikueshëm publik. Sidoqoftë sektori i OJQ-ve është akoma i pazhvilluar dhe duket mjaft i dobët në drejtim të kapacitetit, me një numër të OJQ-ve të shquara për hulumtime dhe mbështetje të financuara nga donatorë ndërkombëtarë. OJQ-të tjera janë mjaft të dobëta dhe të fragmentuara. Që nga viti 2012, shoqëria civile mund të përfshihet në monitorimin e zbatimit të ndihmës së BE-së përmes pjesëmarrjes në mbledhjet dyvjeçare për monitorim të IPA-s. Kjo është një mundësi kryesore për organizatat e shoqërisë civile (OSHC-të) ta rrisin profilin e të drejtave të fëmijëve, të ndikojnë në qeveri, te donatorët dhe bashkësia ndërkombëtare, dhe t'i zgjerojnë rrjetet e tyre dhe mbrojtjen e parimeve të synuara.

Në Maqedoninë e Veriut ekzistojnë disa OJQ që merren me çështjen e fëmijëve, veçanërisht për fëmijët me aftësi të kufizuara. Shoqatat e prindërve që veprojnë nën flamurin e Këshillit Nacional të Organizatave për Persona me Aftësisë së Kufizuar japin një shembull pozitiv se sa OJQ-të lokale mund të kontribuojnë në realizimin praktik të të drejtave të fëmijëve, por ka pak organizata të tilla ombrellë, të përqendruara vetëm te fëmijët në vend, si dhe shumica e OJQ-ve lokale janë të bazuara në projekte dhe varen nga donatorët. Të dhënat e Komitetit për të Drejtat e Fëmijës (KDF) tregojnë se një Koalicion i OJQ-ve për të drejtat e fëmijëve ka dorëzuar një raport alternativ në vitin 2007, por për fat të keq nuk ka prova që ai ekziston akoma. Edhe pse Ambasada e Parë e Fëmijëve dhe SEGA (një koalicion nacional i organizatave rinore që morën pjesë në përpilimin e Raportit Suplementar për KDF) kanë dëshmuar kapacitetin dhe aftësinë e tyre për t'i promovuar të drejtat e fëmijëve dhe për t'i mbrojtur ato së bashku me fëmijët dhe për fëmijët, megjithatë spektri jashtëzakonisht i kufizuar i palëve të shoqërisë civile të angazhuar me çështje të fëmijëve paraqet një pengesë të vërtetë për realizimin e të drejtave të fëmijëve në nivelin nacional dhe atë lokal.

(iii) Mediumet

Përderisa KE-ja ka vërejtur¹¹⁹ se klima për lirinë e mediave dhe lirinë e shprehjes është përmirësuar

në Maqedoninë e Veriut në vitin 2018, Freedom House raporto¹²⁰ se gazetarët maqedonas janë subjekt i presionit dhe ngacimit politik, dhe sulmet fizike kundër tyre vazhdojnë, edhe shpeshësia e sulmeve të tilla është zvogëluar gjatë vitit. Ekzistojnë gjashtë gazeta ditore, përfshirë dy në gjuhën shqipe. Spektri mediatik i Maqedonisë së Veriut është i polarizuar përgjatë vijave politike, dhe mediat private shpesh janë të lidhura me interesat politike ose ato të biznesit, që ndikojnë në përmbajtjen e tyre. Kushtet e punës së gazetarëve janë shumë të dobëta, gazetarët mbesin financiarisht mjaft të pasigurt dhe për rrjedhojë, ende e praktikojnë vetë-censurimin.

Në përgjithësi, besimi në lajmet e mediave është i ulët¹²¹. Ky nivel i ulët i besimit mund të jetë për shkak të polarizimit të mediave përgjatë linjave politike, por gjithashtu ka të ngjarë ta reflektojë dëshirën e publikut për informacion më objektiv. Media në internet është e parregulluar, andaj është i shpeshtë edhe dezinformimi, gjuha e urrejtjes, mosrespektimi i standardeve profesionale dhe shkeljet e të drejtave të pronësisë intelektuale. Masat ligjore dhe/ose parimet e vetë-rregullimit dhe transparencë e pronësisë janë të nevojshme për ta rritur respektimin e etikës dhe profesionalizmit në mediat onlajn.

Interesimi i mediave për çështjet e fëmijëve është mjaft i ulët. Në fakt as mediat e shkruara e as ato elektronike nuk marrin rol kryesor në diskursin për të drejtat e fëmijëve, megjithëse zakonisht mediat kryesore i mbështesin fushatat për të drejtat e fëmijëve. Në përgjithësi, fëmijët nuk prezantohen në media në mënyrë që i respekton të drejtat e tyre. Gazetarët nuk janë të detyruar të trajtohen në lidhje me raportimin e bazuar në të drejtat e fëmijëve, me çka edhe trajtimi i fëmijëve në media mund të jetë mjaft sensacionalit dhe pa ndonjë respekt ose konsideratë për të drejtat ose mirëqenien e fëmijës. Mediat shpesh e injorojnë të drejtën e fëmijës për privatësi dhe tregimet e fëmijëve shpesh paraqiten në një mënyrë sensacionale. Ekziston shumë pak ndërveprim ndërmjet OJQ-ve dhe gazetarëve për të ofruar pikëpamje alternative si një mënyrë për të balancuar lajmet ose për të përdorur ekspertizën e pavarur.

119 North Macedonia 2019 Report European Commission op cit

120 Shih Freedom in the World 2019 available at <https://freedomhouse.org/report/freedom-world/2019/north-macedonia>

121 Eurofound (2019) op cit

Sistemet aktuale të asistencave socialë nuk i marrin parasysh dyparitetet sociale dhe ekonomike ndërmjet komunave. Komunat rurale dhe ato të vogla janë në veçanti në gjendje të pavolitshme.



(iv) Komuniteti

Komuniteti është institucion kryesor në Maqedoninë e Veriut dhe një element i fortë i jetës individuale, familjare dhe shoqërore. Në fakt ka tendencë që komunitetet të harmonizohen, dhe përcaktohen për nga etnia. Një e treta e të anketuarve (33%) në studimin¹²² e HECJ-së raportuan tension midis grupeve të ndryshme racore ose etnike. Përqindjet ishin të ngjashme në këtë drejtim midis atyre që e flasin gjuhën shqipe dhe ata që e kanë gjuhë amtare gjuhën maqedonase. Ekziston gjithashtu një ndarje në rritje midis komuniteteve urbane dhe rurale. Të dhënat e HECJ-së¹²³ treguan se 72 për qind e popullsisë ka jetuar në ambiente urbane në vitin 2016, përqendrimi më i lartë (20.5%) ishte në Shkup. Vlerësimet¹²⁴ e Entit Shtetëror të Statistikës tregojnë se të paktën 45 komuna kanë rritje negative të popullsisë, që do të thotë se të gjitha komunitetet do të përballen me shpopullimin e vazhdueshëm gjatë dekadës tjetër. Rreth 10 për qind e të anketuarve në sondazhin nacional¹²⁵ të Vlerësimit ndër-sektorial të të rinjve kishin migruar nga zonat rurale në ato urbane në pesë vitet e

fundit. Varfëria është më e lartë në zonat¹²⁶ rurale dhe meqenëse punonjësit arsimor, profesionistët e shëndetësisë dhe të kujdesit shoqëror ende nuk dëshirojnë të pranojnë caktimin në detyrë në vende të largëta, entet janë të shpërndara, dhe ofrimi i shërbimeve është më i kushtueshëm. Gjithashtu edhe shpërndarja gjeografike e popullsisë në të gjithë vendin është e tillë që shumë komuna dominohen në mënyrë efektive nga një grup i vetëm etnik dhe interesave të grupeve tjera etnike brenda zonës nuk iu jepet gjithmonë vëmendja e duhur. Si rezultat i kësaj, shumë familje në zonat rurale që jetojnë tashmë me varfëri, privim të shumfishtë dhe përjashtim shoqëror gjithashtu përballen edhe me izolim gjeografik dhe ulje të qasjes në shërbime.

Migrimi është “duke brejtur” bashkësitë urbane dhe rurale dhe është duke kontribuar në një cikël varfërie, i cili po i varfëron burimet kryesore të komuniteteve lokale - të rinjtë. Megjithatë shkalla neto e migracionit është e ulët, kryesisht janë të rinjtë e moshës së punës që largohen. Në mënyrë të pashmangshme kjo varfëron si forcën e punës ashtu edhe bazën e taksave¹²⁷, dhe

122 Eurofound (2019) op cit

123 Eurofound (2019) op cit

124 Regjistri vjetor i Republikës së Maqedonisë, 2018 ESHS op cit Kapitulli 03 Popullsia

125 Zlvetz L./ Navanti Group (2019) op cit.

126 Të dhënat në vijim janë nga Seizing a Brighter Future for All Former Yugoslav Republic of Macedonia Systematic Country Diagnostic World Bank Group (2018) op cit.


127 Shih Seizing a Brighter Future for All Former Yugoslav Republic of Macedonia Systematic Country Diagnostic World Bank (2018) op cit. for a fuller discussion

potencialisht do ta zvogëlojë rritjen e popullsisë në dekadën e ardhshme. Sondazhet¹²⁸ e fundit të të rinjve në Maqedoninë e Veriut tregojnë se kjo prirje ka të ngjarë të vazhdojë dhe mbase të rritet në dekadën e ardhshme. Vetëm një e treta e të anketuarve në studimin¹²⁹ e Friedrich Ebert Stiftung (FES) (33%) treguan se ata nuk dëshirojnë të emigrojnë dhe gjysma e të rinjve në anketën nacionale të Vlerësimit ndër-sektorial të të rinjve¹³⁰ shprehen qëllimin e tyre për ta braktisur vendin në 1-2 vitet e ardhshme.

Meqenëse fuqizimi ekonomik është motivi kryesor për emigracionin, zhgënjimet gjerësisht të krijuara me tendencat politike mbizotëruese dhe sfidat e stilit të jetesës gjithashtu kontribuan në vendimet e të rinjve për t'u larguar nga vendi. Rezultatet¹³¹ e Vlerësimit ndër-sektorial të të rinjve sugjerojnë që dëshira për të migruar është statistikisht më e

fortë në mesin e atyre të rinjve që ndjehen më të përjashtuar nga shoqëria kryesore - të papunët; pakicat etnike përfshirë ata që identifikohen si shqiptarë; dhe ata që identifikohen si LBGTI. Kjo sugjeron që mund të ketë ndikime të forta paragjykimesh, intolerancash dhe përjashtimesh sociale brenda komuniteteve të Maqedonisë së Veriut drejtuar atyre që perceptohen të jenë të ndryshëm. Armiqësia dhe dhuna e përshkruar nga të rinjtë LBGTI në studimin¹³² e FES duket se konfirmojnë një gjë të tillë. E njëjtë është edhe përvoja e fëmijëve dhe familjeve rome anekënd vendit. Rrjeti Akademik i Ekspertëve Evropian për Paaftësi RRAEEP (ANED) e pranon¹³³ "stigmën e aftësisë së kufizuar" të përhapur në fshatra dhe qytete¹³⁴. Është dëshpëruese të theksohet se paragjykimet ndaj pakicave dhe ato që ndryshojnë nga norma ishin akoma të dukshme në qëndrimet e pjesëmarrësve të rinj në studimin e FES-së¹³⁵.

Gjysma e të rinjve e kanë shprehur qëllimin e tyre për ta braktisur vendin në 1-2 vitet e ardhshme.



128 Shumica e të anketuarve në Zlvetz L./ Navanti Group (2019) op cit dhe Topuzovska Latkovikj (2019) M. et al op cit. theksojnë se migrimi ka qenë opsion i preferuar për ta

129 Topuzovska Latkovikj M. et al (2019) M. op cit

130 Zlvetz L./ Navanti Group (2019) op cit

131 Ibid


132 Topuzovska Latkovikj M et al (2019) op cit

133 Shavreski Z. Kochoska E. (2019) ANED op cit

134 Kishte një thirrje për rezistencë masive nga banorët e Timjanikut, kur mësuan për planet për të ndërtuar një shtëpi grupore në fshatin e tyre. Thirrja për rezistencë masive u bë përmes mediave. Pas diskutimeve intensive midis anëtarëve të komunitetit, qeverisë dhe palëve të tjera përkatëse, shtëpia u ndërtua dhe po funksionon me sukses me mbështetjen e plotë të komunitetit. Shih <https://plusinfo.mk/%D0%B1%D1%83%D0%BD%D1%82-%D0%B2%D0%BE-%D0%BD%D0%B5%D0%B3%D0%BE%D1%82%D0%B8%D0%BD%D1%81%D0%BA%D0%BE%D1%82%D0%B8%D0%BC%D1%98%D0%B0%D0%BD%D0%B8%D0%BA-%D0%BD%D0%B5-%D1%81%D0%B0%D0%BA%D0%B0%D0%B0%D1%82/>.

135 Topuzovska Latkovikj M et al (2019) op cit

Rreth 70 për qind të prindërve me fëmijë të moshës 0 deri në 6 vjeç mbështeten te gjyshërit, vëllezërit/motrat ose anëtarët tjerë të familjes, me qëllim që të kujdesen për fëmijët.



(v) Familja

Familja është bërthama kryesore e shoqërisë së Maqedonisë së Veriut në të gjitha grupet etnike dhe shoqërore dhe ende perceptohet të jetë mbrojtësi kryesor i interesave të fëmijëve. Rrjetet e familjes tradicionale janë të forta, ashtu që familjet me tre gjenerata janë të zakonshme, veçanërisht në zonat rurale¹³⁶. Edhe kur vëllezërit dhe motrat jetojnë larg shtëpisë ku jeton familja, anëtarët e gjere të familjes kanë tendencë të përfshihen shumë në rritjen e fëmijëve. Në një studim të kohëve të fundit¹³⁷, afërsisht 73 për qind e prindërve me fëmijë të moshës 0 - 2 vjeçare dhe 72.9 për qind me fëmijë nga 3 deri në 6 vjeç mbështeten te prindërit e tyre, motrat ose vëllezërit ose anëtarët e tjerë të familjes për kujdesin e fëmijëve. Megjithëse modernizimi po ndryshon në mënyrë të pashmangshme strukturën dhe dinamikën e jetës familjare, një angazhim i fortë me dhe për familjen e zgjeruar është ende një normë e vlerësuar sociale. Pjesërisht, por jo plotësisht, për arsye ekonomike të rinjtë ende kanë tendencë të jetojnë në shtëpi edhe në fund të njëzetave të tyre.

Tradicionalisht, dinamika e familjes ka qenë patriarkale, ku mashkulli më i vjetër

(zakonisht gjyshi) e kishte fuqinë më të madhe vendimmarrëse. Sot vendimet familjare janë më të bazuara në konsensus edhe pse mosha ende vlerësohet shumë, dhe anëtarët e moshuar të familjes kanë një autoritet të rëndësishëm. Sidoqoftë, rolet gjinore mbeten mjaft tradicionale, ku gratë marrin pjesën më të madhe të përgjegjësisë për punët e shtëpisë dhe kujdesin ndaj fëmijët. Fuqia e modelit të familjes së zgjeruar është e tillë, që presioni social ndaj prindërve të vetëm është i lartë në bashkësi të vogla. Prindërit e vetëm dhe fëmijët e tyre mund të ndjehen të stigmatizuar dhe të përjashtuar nga shoqëria dhe të jetuarit me vetëm një burim të të ardhurave mund të ulin ndjeshëm cilësinë e jetës së fëmijës.

Dhuna duket të jetë një tipar i fshehur por i pranuar edhe i jetës familjare. Një sondazh¹³⁸ i bërë nga Zyra e UNICEF në Shkup mbi njohuritë, qëndrimet dhe praktikatat të ndërlidhura me format e dhunshme të disiplinës së fëmijëve tregon se një shumicë e madhe (79%) e prindërve kanë përdorë të paktën një metodë të dhunshme (p.sh. agresion psikologjik; ndëshkim të vogla ose të rënda fizike), ndërsa vetëm 21 për qind përdorin vetëm metodat e prindërimit pozitiv

136 See Cultural Atlas Macedonia available at <https://culturalatlas.sbs.com.au/macedonian-culture/family-a0847809-fab6-494c-8c7e-633970c21dab>

137 Promoting alternative childcare services Fieldwork Report of Survey among Parents WYG International (2017) Skopje


138 GFK Skopje Survey on parents' and caregivers' Knowledge, Attitudes, Practices & social norms associated with Violent Forms of Child Discipline UNICEF (2017) Skopje associViolent Forms of Child Discipline

dhe jo-të dhunshëm. Njashtu sondazhi në fjalë tregon se 73 për qind të dëshmitarëve nuk e kanë raportuar dhunën ndaj një fëmije. Duhet të theksohet se përderisa shumica e prindërve/kujdestarëve ishin në gjendje ta identifikojnë të paktën një ndikim negativ që dhuna fizike (72%), dhe ndëshkimi psikologjik (67%) ka në mirëqenien fizike dhe emocionale të fëmijëve, një numër i konsiderueshëm (44% dhe 37% respektivisht %) ende besonin se ato janë mënyra efektive për ta korrigjuar sjelljen e fëmijës.


Strukturat familjare janë duke u prekur nga modernizimi, veçanërisht urbanizimi, me çka vërehet një rënie afatgjate e niveleve të lindjeve dhe plakjes demografike. Vërehet një rënie e numrit të martesave, si dhe rritje të numrit të

lindjeve jashtë martesore dhe prindërve beqarë. Numri i shkurorëzimeve është rritur në mënyrë të vazhdueshme që nga viti 1991 dhe ka arritur në 1.985 në vitin 2016. Përderisa shumica e fëmijëve ende lindin dhe rriten nga familjet me të dy prindërit, modeli i marrëdhënieve familjare është duke ndryshuar. Shkalla e lindjeve shënon rënie, ndërsa mosha mesatare në martesë është rritur. Më shumë çifte jetojnë të ndarë nga prindërit dhe të afërmit e tjerë (megjithëse mbajtja e kontakteve të forta familjare mbetet normë). Njerëzit janë më të hapur për problemet brenda familjes dhe gratë janë më pak të përgatitura për të qëndruar në marrëdhënie abuzive. Mund të ketë nevojë që qeveria të veprojë në drejtim të ribërjes së politikave për familjen.

Shumica dërmuese e prindërve (79%) e kanë përdorë së paku një metodë të dhunshme (p.sh. agresion psikik, dënim të lehtë ose të rëndë), nga ana tjetër vetëm 21% kanë përdorë vetëm metoda pozitive dhe jo të dhunshme.



Shumica dërmuese (67%) e prindërve/kujdestarëve pajtohen me qëndrimin tradicional që fëmija nuk guxon t'ia kthej fjalën të rriturit.



k. Dijsa, qëndrimet dhe praktikat

Megjithëse ende nevojitet përpjekje për ta harmonizuar legjislacionin, politikat dhe strategjitë nacionale në përputhje me normat dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, gjegjësisht ndërtimit të kapacitetit të sistemeve, strukturave dhe institucioneve për t'i realizuar të drejtat e fëmijëve, prapëseprapë duket se njohuritë, qëndrimet dhe praktikat e të rriturve do të jenë pengesa më e rëndësishme për realizimin e të drejtave të fëmijëve në Maqedoninë e Veriut. Edhe pse Maqedonia e Veriut është një shtet i ri, ajo është një shoqëri e plakur me një rënie të nivelit të lindjeve dhe një numër i madh i kapitalit të saj njerëzor zvogëlohet si rezultat i migrimit. Fëmijët nuk gëzojnë një prioritet të lartë brenda administratës qeveritare ose shoqërisë më të gjerë, si dhe nuk ekziston një lobi i fortë i fëmijëve midis OJQ-ve, botës akademike ose mediave. Si rezultat i kësaj është e heshtur kërkesa për ndryshim pozitiv për fëmijë, madje ka një presion të pamjaftueshëm për bartësit e detyrave për t'i përmbushur përgjegjësitë e tyre ndaj fëmijëve.

Normat shoqërore në lidhje me fëmijët nuk janë as të bazuara në të drejta dhe as domosdoshmërisht

nuk janë të përqendruara tek fëmijët, andaj shumë prindër nuk kanë njohuri të mjaftueshme për të drejtat e fëmijëve dhe vlerën e një kornize të të drejtave të fëmijëve për jetën familjare. Qëndrimet tradicionale ndaj roleve gjinore dhe pranimit pasiv i dhunës ndaj grave dhe fëmijëve mundësojnë një përhapje të papranueshme të lartë të dhunës në shtëpi, shkolla dhe institucione. Pritjet e familjeve për angazhimin e grave si kujdestarë pa pagesë e zvogëlojnë pashmangshëm kërkesën për reformën e politikave ose ofrimin e shërbimeve për fëmijët. Për shembull kur kujdesi për fëmijët është i disponueshëm brenda familjes më të gjerë, prindërit priren të vendosen për këtë opsion sesa të kërkojnë hapjen e më shumë vendeve për edukim parashkollor të fëmijëve, gjë që mund të sjellë përfitim më të madh për fëmijën. Kur këto pritshmëri të ulëta kombinohen me shqetësimet për stigmën¹³⁹ sociale, ndoshta ushtrojnë me shumë presion për t'i mbajtur në shtëpi fëmijët me aftësi të kufizuara, me çka përsëri pengohet integrimi i tyre në sistemin e rregullt arsimor¹⁴⁰. Ekziston një nevojë e qartë për fushata arsimore në lidhje me vlerën dhe përfitimet nga vetëdija për gjininë, qasja e bazuar në të drejtat e fëmijëve për rritjen e fëmijëve dhe mbështetjen e familjes në Maqedoninë e Veriut, që kanë për qëllim prindërit, profesionistët dhe hartuesit e politikave.

139 Shih Shavreski Z. Kochoska E. Shavreski Z. Kochoska E. Living independently and being included in the community ANED (2019) Brussels

140 Shih GFK Skopje Follow-up Survey on Knowledge, Attitudes, Practices towards Inclusion of Children with Disabilities UNICEF (2018) Skopje available at <https://www.unicef.org/northmacedonia/reports/follow-survey-knowledge-attitudes-practices-towards-inclusion-children-disabilities>

Vetë fëmijët nuk konsiderohen si bartës të të drejtave në familjet ose komunitetet. Ekziston tendenca që fëmijët më shumë të perceptohen si pranues të kujdesit dhe mbrojtjes, sesa si qytetarë të rinj, madje rrallë kërkohet të shprehen pikëpamjet e tyre. Një shumicë e madhe (67 për qind)¹⁴¹ e prindërve/kujdestarëve ndajnë qëndrimin tradicional, që fëmijë nuk duhet t'ia kthejë fjalën një të rrituri, ndërsa 64 për qind besojnë se fëmijët kanë qenë më të disiplinuar kur kanë qenë më të vegjël. Një përqindje jashtëzakonisht e ulët e prindërve përmendin, kureshtjen (3 për qind), vëmendshmërinë (2 për qind), ambicien, vetëbesimin, pavarësinë dhe këmbëngulësinë (1 për qind), dhe kreativitetin (0,5 për qind) si cilësi të një fëmije "të mirë".

Ka shumë pak mekanizma për përfshirje të fëmijëve në vendime që kanë të bëjnë me ata, madje edhe këto shpeshherë injorohen nga të rriturit. Një numër në rritje i organizatave rinore po e sfidojnë këtë mendje, por përqendrimi i tyre ka tendencë të jetë të të rriturit e rinj sesa të fëmijët. Opinione të fëmijëve kërkohen rrallëherë, kur planifikojnë shërbimet që kanë të bëjnë me ta dhe si rezultat i kësaj, programet rrallëherë planifikohen ose dorëzohen në një mënyrë të përqendruar tek fëmijët ose të bazuar në të drejtat, gjë që në mënyrë të pashmangshme zvogëlon efikasitetin, rëndësinë dhe efektivitetin e kostos së tyre. Edhe pse zgjerohen mundësitë për të rinjtë të moshës 15-24 vjeçare të përfshihen në vendimmarrje, prapëseprapë mundësia që zërat e fëmijëve të dëgjohen është ende mjaft e kufizuar. Kjo çështje duhet të adresohet brenda një lëvizjeje më të gjerë për të forcuar dhe shtrirë pjesëmarrjen aktive të publikut në hartimin e politikave dhe planifikimi e programit.

Rekomandimet e Përgjithshme

1. Urgjentisht duhet të hartohet një Plan i ri nacional i veprimit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, ndërsa Komisioni Nacional për të Drejtat e Fëmijëve (KNDF) duhet të rigjallërohet, forcohet dhe furnizohet me resurse. Njëra ndër detyrat kryesore të Komisionit duhet të jetë shtrirja e spektrit të mbështetjes për të drejtat e fëmijëve dhe përfshirja e një game më të gjerë të bartësve të detyrave për hulumtim, mbrojtje dhe programim

për fëmijët dhe me fëmijët. Të gjithë bartësit e detyrave duhet të përpiqen, ta angazhojnë sektorin e biznesit në rritjen, promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe të llobojnë me ta për një shoqëri më të ndershme dhe më të barabartë, e cila e mbështet çdo fëmijë për ta realizuar potencialin e tij të plotë.

2. Ekziston një nevojë e fuqishme për fushata arsimore publike për t'i sfiduar pabarazitë dhe ndarjet ekzistuese dhe për t'ua shpjeguar hartuesve të politikave, profesionistëve dhe publikut të gjerë se si përvetësimi i një qasjeje të bazuar në të drejta, të fokusuar në barazi dhe përmbushje të përgjegjësisve të tyre ndaj fëmijëve, mund të sjellë përfitime për shoqërinë më të gjerë në Maqedoninë e Veriut. Veçanërisht këto fushata duhet t'i promovojnë investimet në shëndetin e nënës dhe fëmijës, edukimin hershëm të fëmijëve dhe iniciativat e përfshirjes sociale që kanë një shkallë të lartë të dobisë për shoqërinë.

3. Të gjithë palët përkatëse duhet të bashkëpunojnë për ta zhvilluar një strategji për përmirësim të cilësisë së proceseve vendimmarrëse ligjore, që kanë të bëjnë me fëmijët, dhe të përcaktojnë pritshmëri të qarta për të gjitha Ministrinë dhe Departamentet në lidhje me konsultimet me fëmijët, familjen dhe shoqërinë civile; koordinimin ndër-sektorial; llogaridhënien dhe transparencën; adresimin e pabarazisë gjinore dhe dallimet tjera; si dhe promovimin e përfshirjes sociale. Në veçanti KNDF-ja duhet ta lehtësojë zhvillimin e strategjive të qarta ndër-sektorale për ta adresuar përjashtimin shoqëror të popullsisë të caktuar, veçanërisht atyre të cënueshme të fëmijëve, përfshirë fëmijët romë, fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët migrantë dhe fëmijët në paraburgim ose përkujdesje institucionale.

4. Qeveria duhet ta hartojë dhe zbatojë me urgjencë një Plan emergjent të gatishmërisë, të favorshëm për fëmijët, i cili e parandalon dhe zbut ndikimin e katastrofave të mundshme klimatike ose të shkaktuara nga njeriu, si pasojë e së cilave do të pësojnë fëmijët. Me këtë synohet që të forcohet rezistenca dhe aftësitë e familjeve dhe komuniteteve për t'i shmangur, mbijetuar dhe për t'u rikuperuar nga pasojat e katastrofave të tilla.

141 GFK Skopje Survey on parents' and caregivers' Knowledge, Attitudes, Practices & social norms associated with Violent Forms of Child Discipline UNICEF (2017) op cit.

5. Duhet të bëhet një analizë gjithëpërfshirëse dhe e thelluar e shpenzimeve qeveritare për fëmijët që identifikon fushat e kursimeve të mundshme, ku paratë mund të transferohen në buxhetet e dedikuara fëmijëve, dhe në fondet brenda buxheteve aktuale për fëmijët, që të mund të përdoren me një kosto shumë më efektive. Në këtë drejtim mund të përfshihet një analizë e dobishme e procesit aktual të decentralizimit, ku fëmijët janë në fokus, e cila identifikon vështirësitë dhe pengesat e qasjes gjithëpërfshirëse për adoptimin e një qasje të bazuar në të drejta dhe të fokusuar te fëmijët, me qëllim të përmbushjes së nevojave të fëmijëve në nivelin lokal.
6. Të gjithë bartësit e detyrave duhet të bashkëpunojnë mes vete, për të shmangur një krizë të mundshme të fuqisë punëtore në shërbimet e fëmijëve. Atë duhet ta bëjnë përmes hartimit të një strategji për ta përmirësuar standardin, kualifikimet dhe aftësinë e profesionistëve të rinj, që i bashkëngjiten shërbimeve ose agjencive për punë me fëmijët dhe përmes ruajtjes së stafit me përvojë. Strategjia gjithashtu duhet të adresojë çështjen e ndërtimit të menaxhimit, kapacitetit profesional dhe përgjegjshmërisë; rritjen e vullnetit të stafit përmes zhvillimit dhe zgjerimit të vazhdueshëm profesional; mënjanimin e ngatërresave dhe pengesat ekzistuese; zbatimin e praktikave të mira dhe qasjen e plotë në shërbimet cilësore.
7. Po ashtu edhe nga komunave duhet të kërkohet ta rishikojnë efektivitetin dhe efikasitetin e shërbimeve shëndetësore, arsimore dhe atyre sociale, që kanë të bëjnë me fëmijët brenda fushëveprimit të tyre, si dhe të rekomandojnë mundësi praktike për të përmirësuar fokusin, shtrirjen, cilësinë, efektivitetin dhe efikasitetin e tyre. Analizat e modeleve ekzistuese të ofrimit të shërbimeve mund të ndihmojnë në ndërtimin e aftësive të komunave për të zhvilluar modele të reja, që i adresojnë çrregullimet e baraspeshës dhe pabarazitë lokale.
8. Në përputhje me nenin 2 të Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijës, të gjitha materialet që lidhen me të drejtat e fëmijëve duhet të botohen në maqedonisht dhe shqip, ndërsa përkthimi në gjuhët e minoriteteve të tjera duhet të jetë gjithnjë i disponueshëm.
9. Duhet të përditësohen sistemet dhe mekanizmat nacionale të mbledhjes së të dhënave, për të siguruar që ka të dhëna të mjaftueshme në dispozicion për ta mbështetur formulimin e politikave, planifikimin e programeve dhe zhvillimin e shërbimeve në lidhje me popullatat veçanërisht të prekshme të fëmijëve p.sh. fëmijët romë, fëmijët në paraburgim, fëmijët migrantë.
10. Për ta zhvilluar një kulturë të mirëfilltë të të drejtave të njeriut, duhet të ndihmohen fëmijët dhe të rinjtë për të marrë pjesë më aktive në diskursin publik dhe për t'i proklamuar mendimet dhe idetë e tyre. Numri dhe fushëveprimi i organizatave dhe iniciativave në Maqedoninë e Veriut, që e lehtësojnë përfshirjen e fëmijëve në jetën publike është mjaft i kufizuar, kështu që të gjithë protagonistët e zhvillimit duhet ta mbështesin në mënyrë proaktive zgjerimin e mekanizmave dhe modeleve ekzistuese, që fëmijët të marrin pjesë në vendimmarrjen që i tangon ata. Pjesëmarrja e fëmijëve duhet të promovohet dhe lehtësohet si një qasje dhe si një fije thelbësore e diskursit publik dhe planifikimit të shërbimeve.
11. Vëmendje e veçantë duhet kushtuar përkujdesit që modelet dhe mekanizmat e pjesëmarrjes së fëmijëve të zhvillohen në nivelin gjithëpërfshirës të komunitetit dhe atë të nivelit shtetëror, që nuk i ndjek modelet ekzistuese të pabarazisë. Mund të kërkohen nisma të veçanta për ta lehtësuar ndërveprimin dhe dialogun midis ndasive etnike, si dhe mund të nevojiten burimeve shtesë për t'i tejkaluar pengesat për pjesëmarrjen e plotë në shoqëri me të cilat përballen vajzat, romët, fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët e familjeve të varfra dhe fëmijët që jetojnë në zona rurale. KNDF-ja duhet të sigurojë që këto grupe të ndihmohen, që të përfshihen në planifikimin e strategjisë nacionale.
12. Përkundër ekzistencës së moduleve për të drejtat e fëmijëve në kurset e arsimit dhe trajnimit të mediave lokale, në media vazhdojnë të abuzohen të drejtat e fëmijëve për privatësi, ndërsa çështjet dhe situatat që kanë të bëjnë me fëmijët vazhdojnë të marginalizohen, keq-përfaqësohen dhe të paraqiten si lajme sensacionale. Fëmijët dhe të rinjtë duhet të mbështeten për ta sfiduar praktikën e dobët në media dhe duhet të aftësohen që të formojnë, hartojnë dhe udhëheqin në mënyrë aktive një fushatë për t'i avancuar standardet e shtypit për të drejtat e fëmijëve.

Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijet (UNICEF)

Orce Nikolov 74, 1000 Shkup

tel: ++ 389 2 3231150

faks: ++ 389 2 3231151

e-mail: skopje@unicef.org

Ndiqni UNICEF MK në Facebook, Twitter, YouTube dhe në www.unicef.mk